Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Pavarur. Viti III i Botimit. **Nr. 3(23).** **Mars 2008** Çmimi: **50** lekë, **20** dinarë

NJOFTIM

Më 27 maj 2008, me rastin e 2-vjetorit të krijimit Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" do të mbahet sesioni shkencor me temë:
"DIBRA NË OPTIKËN E TË HUAJVE".
Ftohen të gjithë ata që kanë informacion të hollësishëm rreth kësaj teme të konfirmojnë kumtesat e tyre në këtë numër telefoni: **068 31 19 232** *ose email:* **Lid_gazeta@yahoo.com.**

Rruga e Arbërit nuk është ëndërr

Intervistë me z. Shaban Bitri, administrator i kompanisë "Almo Konstruksion", që aktualisht po punon në Rrugën e Arbërit

Brenda tremujorit të fundit apo dhe me fillimin e vitit të ardhshëm them se dhe pjesa tjetër që fillon në Bulqizë përfshi këtu dhe tunelin e Qafës së Buallit me distancë 800 metra linear dhe deri në Urën e Vashës, mund të përfundojë tenderimi. Ka përfunduar projekti teknik për segmentin tjetër nga Ura e Çerenecit në Gjoricë dhe pritet të bëhet tenderi shumë shpejt. Atëherë do të binden të gjithë se traseja e Rrugës së Arbërit zgjatet drejt Tiranës dhe nuk mund ta ndalojë askush.

FAQE 3

Në brendësi:

Dhurohet gjak për të plagosurit e tragjedisë së Gërdecit
FAQE 2

Drini i Zi "i fal" Maqedonisë qindra hektarë të tokës shqiptare
FAQE 2

Asfaltimi i rrugës e gjallëron Bohmovën
Nga REXHEP TORTE
FAQE 4

Ma dallgëzove shpirtin Velo Cfarku
NGA ABDURAHIM ASHIKU
FAQE 8

Haxhi Skënderi (Ademi), një emër i njohur në arsimin shqiptar
FAQE 10

Kultivimi i sherbelës, një mundësi e mirë investimi
Nga DALI HORESHKA
FAQE 11

ALEGORI

Me folë dibranisht

Nga **Agron TUFA**

Më folë dibranisht nuk don të thotë medoemos të flasësh në dialektin e Dibrës (nga është vetë autori); dibranishtja si gojëfolje e nëndialektit gegë, me arealet e saj, sugjeron vetëm efekte ekzotike gjuhësore dhe të tilla i gjen në çdo krahinë shqiptare, sa më në thellësi të shtyhesh. Përfytyroni një nga figurat më qendrore të mitit tonë kombëtar, nipin e Palit, birin e Gjon Kastriotit, Gjergj Kastriot – Skëndërbeun nga Sina-Kastrioti i Dibrës, duke folur dibranishten e shekullit XV... Mjafton kjo për të rrëzuar përceptimet ksenofobike ndaj gojëfoljeve dialektore të botës shqiptare, si paragjykime mendjelehta të lindura shumë vonë, pas ujdisjes së gjuhës standarde.

Me folë dibranisht, unë nënkuptoj një cilësi ligjërimi krejt të veçantë që përbën jo mbështjelljen fonetike të folësit, por, para së gjithash, botën e tij filozofike, estetike dhe psiko-mentale.

(FAQE 5)

KUJTESE

PO VJEN SHKENCËTARI HILMI KOLGJEGJA

Nga **XHAFER MARTINI**

Kur mësova që Hilmi Kolgjegja vuante nga një sëmundje e rëndë, vendosa ta shikoj, por hë sot hë nesër, veç kur mora vesh që ai kishte ndërruar jetë. E mora vesh nga goja e njerëzve, sepse mjetet e informimit nuk thanë asnjë fjalë për humbjen e tij? Ato duhej të thonin, pasi Hilmiu nuk qe një njeri i zakonshëm. Ai i dha shumë kulturës sonë. Është vërtet turp të mos përbëjë lajm vdekja e një njeriu si Hilmi Kolgjegja, në një kohë kur shumë njerëzve, me vlera shumë më të pakta, u kushtohen emisione të veçanta. Libri i Hilmi Kolgjegjës "Folklor nga Dibra"(1990), me 750 faqe, botim i Institutit të Folklorit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është padyshim përmbledhja më e madhe dhe më e rëndësishme e folklorit të mbledhur ndonjëherë në rrethin e Dibrës.

(FAQE 9)

Shënime udhëtimi nga Kulla e Pizës te kullat e Dibrës

Nga **Dr. SELMAN MEZIU**
Faqe 6-7

Të shfletosh dosjen e një udhëtimi, është kënaqësi shpirtërore. Të vizatohen peisazhet, ngjarjet, njerëzit, të cilët tregojnë diçka, e më pas futesh në rrugicat e monopatet e saj e bëhesh plotësisht i tyre. Imagjinata merr udhë e bashkë me të edhe fizikisht lodron, rrëmbehesh, emocionohesh...

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com. www.dibra.org

Për të plagosurit në tragjedinë e Gërdëcit të Tiranës

Dhurohet gjak për të plagosurit e tragjedisë së Gërdecit

Banorët e dy Dibrave me shqetësim të madh e ndoqën tragjedinë e shpërthimit të predhave në Gërdec të Vorës në Tiranë. Apelit të mjekëve për dhurimin e gjakut për viktimat nga shpërthimi i predhave në Gërdec të Tiranës, banorët e Dibrës së Madhe në Maqedoni dhe Dibrës së Vogël-Peshkopisë në Shqipëri, të shtunën e kobshme iu përgjigjën menjëherë.

Pushteti vendor në Dibër të Madhe me në krye Argëtim Fida, kryetar i komunës dhe Nizamedin Papraniku, kryesues KK, organizuan urgjentisht nisjen e 30 dhjetë të rinjve dhe qytetarëve për në Bankën e Gjakut në Spitalin e Dibrës së Vogël-Peshkopi për të dhuruar gjak, ndërsa edhe dhjetëra të rinj të tjerë pritnin lajmin për tu nisur.Të parët dhruan gjak Argëtim Fida, Ilir Krosi dhe Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës së Madhe.

Në foto: Argëtim Fida,kryetar i komunës së Dibrës së Madhe dhe Ilir Krosi,kryebashkiak i Peshkopisë duke dhuruar gjak

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe, pas dhurimit të gjakut, për mediat deklaroi se:"Kjo tragjedi e rëndë që sot i ndodhi kombit tonë, te shqiptarët në Dibër të Madhe, si edhe në tërë Maqedoninë shkatoi brengosje dhe shqetësim të madh. Me kërtë gjest simbolik tonin, por edhe me gatishmërinë e qindra të rinjve të tjerë për të dhuruar gjak, nga Dibra, Tetova e Gostivari, dhe me shkuarjen e tërinjve struganë në Elbasan gjithashtu për tëdhuruar gjak, shprehim solidaritetin tonë për vëllezërit tanë në Tiranë. Ky gjest i jonë tregon se jo vetëm në rastet e gëzimit, por edhe në rastet e hidhërimit e të dhimbjes jemi bashkë dhe do të jemi gjithmonë bashkë. Në spitalin e Dibrës së madhe dhe në Kryqin e Kuq jemi të organizuar që nëse edhe nesër paraqitet nevoja për gjak, ne mund ta organizojmë dhurimin e gjakut edhe te na, e pastaj me frigorifer tadërgojmë në Tiranë. Mekëtë rast po përcjrll brengosjen e tërë intelektualëve dhe banorëve dibranë.Jemi befasuar për të mirë me mobilizimin e tërë strukturave në shtetin shqiptar, me guximin e ushtarëve, policëve, mjekëve, infermjerëve dhe të gaetarëve. Të shpresojmë që numri i të dëmtuarve të jetë sa më i vogël dhe që Shqipëria sa më shpejt ta kalojë këtë problem".

Ilir Krosi, kryebashkiaku i Dibrës së Vogël-Peshkopisë, shtoi se:" U falenderoj nga zemra të gjithëve që u përgjigjët dhe erdhët të dhuroni gjak nga Dibra e Madhe, e që jeni solidarizuar me dhibjen që ne kemi sot në këtë tragjedi të papritur dhe ngjarje tepër të rëndë aksidentale. Edhe shumë banorë të Dibrës së Vogël-Peshkopisë janë solidarizuar me gjendjen dhe po dhurojnë gjak. Ne ju falenderojmë se na jeni gjetur gjithnjë pranë. Ju premtojmë që këtë solidarizim tuajin dëshirojmë tua krthejmë me të mira".

Ardian Bitri, drejtor i spitalit të Dibrës së Vogël-Peshkopi, tha se:"Gjej rastin tu përdhëndes për këtë gjest solidarizimi që tregoni në këtë fatkeqësi të rastit.Nuk më duket befasi sepse Ju solidaritetin e keni treguar edhe në rastet e tjera që ka patur Dibra dhe Shqipëria".

Rexhep TORTE

Bujqësia dibrane e etur për ujë

Ky dimër i butë me shumë pak borë maleve, ka bërë që bujqit dibranë të ndjehen tepër të shqetësuar.

Papunësia e madhe, rritja e vazhdueshme e çmimeve të artikujve ushqimorë themelorë, janë duke e rritur edhe më shumë këtë shqetësim. I vetmi shpëtim për ta ëmbëlsuar këtë krizë ekonomike për bujqit dibranë mbetet bujqësia dhe blegtoria. E si të kultivohet bujqësia e blektoria pa patur ujë për ti ujitur ngastrat me misër dhe ngastrat me jonxhë dhe frutiklutura tjera, pa të cilat vështirë se mund të mbahet bagëtia.

Në foto: Pamje nga stacioni i shkatërruar i motopompave.

Me fat janë ata pak bujq dibranë në ngastrat e të cilëve rrjedh ndonjë prockë me ujë,ndërkaq pjesa dërmuese e bujqve ndjehen shumë të mërzitur dhe të neveritur, sepse nuk u hjek zemra të merren me punimin e tokës, pasi edhe Sistemi i ujitjes nuk funksionon.

Sitemi i ujitjes u paralizua tërësisht për shkak të vjedhjes që hajnët ia bënë Stacionit të motopompave, sidomos vitin që shkoi,duke ia vjedhur të gjitha kabllot elektrike, tërë sistemin e automatikës, instalimin elektrik, të komandimit, transformatorët përforcues, duke i çmontuar edhe katër elektromotorët, secili me peshë nga 2 tonelata. Të gjitha këto hajnët i kanë shitur si hekurishte për afër 20 mijë euro, ndërsa këtij stacioni i kanë shkaktuar një dëm prej qinda mijëra euro.

As Bashkësia e Ujërave "Fusha e Dibrës" dhe as policia, nuk arrijtën ta shpëtojnë Stacionin e motopompave nga ky dëmtim i rëndë që i shkaktuan hajnët.

Tani në pranverë,kur duhet mbjellur tokat e punueshme, më shumë se 1500 hektarë në fushën e Dibrës së Madhe, Taranikut, Bushevës dhe të Kllobçishtit, rrezikojnë të mbeten të papunuara për shkak të mungesës së ujit.

Me këtë bujqve të vyer dibranë pa fajin e tyre u shkaktohet një dëm shumë i madh ekonomik.Bujqve dibranë tani u ka mbetur veçse të shpresojnë që dikush të mëshirohet ta financojë riparimin e Stacionit të motopompave ose realizimin e ndonjë projekti tjetër që do ta sjell ujin në tokat e tyre.

R.T.

Në foto: Pamje e shtratit të lumit Drini i Zi

Dibër e Madhe -Në rripin kufitar Shqipëri-Maqedoni

Drini i Zi "i fal" Maqedonisë qindra hektarë të tokës shqiptare

Muaj më parë mediat elektronike në Republikën e Shqipërisë informuan për shqetësimin e shtetasve të tyre në zonën kufitare, pikërisht në zonën ku lumi Drini i Zi paraqet edhe kufirin natyror prej disa kilometrave mes Shqipërisë dhe Maqedonisë. Shqetësimi i tyre ka të bëje me përmbytjet e tokave shqiptare që ky lum është duke i bërë në rrjedhën e tij përgjatë kufirit. Në disa pjesë të anës së shtratit të këtij lumi banorët e fshatit Gjoricë tashmë kanë ndërtuar qindra metra mure me gur për të penguar depërtimin e mëtutjeshëm të ujit dhe për të mbrojtur tokat e tyre. Ndërkaq Televizioni Publik Shqiptar, në mars të vitit 2003, informoi se: "Lumi Drini i Zi ka dalur nga shtrati për shkak se HC "Spila" në Dibër të Madhe ka hapur portat e digës së liqenit artificial për evakuimin e sasisë së ujit tepricë. Kjo sasi e madhe e ujit ka bërë që lumi Drini i Zi të mbulojë me ujë qindra hektarë tokë në territorin kufitar të Shqipërisë,në fshatrat Tuçep, Gjoricë dhe fshatra tjera.

Duke theksuar se:"Rritja e nivelit të ujit në lumin Drini i Zi, ka mbuluar dhe rrezikon të mbulojë edhe shumë sipërfaqe tjera toke dhe shumë rrugë në fshatrat e Shqipërisë,për çka popullata dhe ekipe të shumta janë angazhuar në vendosjen e gurëve dhe materialeve tjera për pengimin e shtrirjes së këtyre përmbytjeve.

Ky burim i lajmeve, gjithshtu, theksonte se:" Kjo dalje e lumit Drini i Zi nga shtrati ka bërë edhe mbulimin e shenjave kufitare, ndaj janë mdërrmarë masat e nevojshme për të kontaktuar me autoritetet maqedonase, që më vonë të mos lindin mosmarrëveshje eventuale lidhur me vijën ekzistuese kufitare",thoshte ky burim i Televizionit Shtetëror të Shqipërisë.

HC "Spila" te Dibra e Madhe që ndodhet përbri kufirit Shqipëri-Maqedoni,ka filluar së funksionuari para më shumë se tre dekada, duke ndërtuar digën,HC dhe liqenin artificial që mbushet nga uji i lumenjëve Radika dhe Drini i Zi.

Tani që kaluam një dimër të butë e me rreshje të pakta bore, uji i cekët i Drinit të Zi, tregon dhe shtrirjen e pakontrolluar të shtratit të tij në dëm të tokave shqiptare.

R.T.

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI.** Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA.**
Redaksia: **Naim Plaku, Rexhep Torte, Abdurrahim Ashiku, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi**
ADRESA E GAZETËS: **Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.**
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: **lid_gazeta@yahoo.com**

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Intervistë me z. Shaban Bitri, administratori i kompanisë "Almo Konstruksion", që aktualisht po punon në Rrugën e Arbërit

Rruga e Arbërit nuk është ëndërr

U bënë më shumë se dy muaj që po punohet në mënyrë intensive në njërin nga segmentet e Rrugës së Arbërit. Edhe pse ky segment është vetëm 16.9 km, janë plot tetë firma që kanë fituar tenderin për këtë pjesë rruge. Kjo trase është "pushtuar" nga ekskavatorët dhe makineria e rëndë, të cilat gërmojnë çdo ditë nga Ura e Çerenecit deri në Bulqizë. Për t'u njohur më shumë me volumet e kryera për këtë periudhë kohe, me veprat e artit, me fondin e dhënë, intervistuam inxhinierin me përvojë të gjatë zotin Shaban Bitri, i cili është dhe administratori i kompanisë "Almo Konstruksion", kompani kjo që po punon në lotin tre të këtij segmenti.

Rruga e Arbërit tashmë ka filluar. Sipas projektit teknik, më së shumti po punohet në trasenë ekzistuese. Përse fillimi nisi pikërisht tek Ura e Çerenecit? A mos vallë mund të jetë një zhgënjim për dibranët se kemi të bëjmë me një ristrukturim të rrugës ekzistuese dhe jo fillim të asaj që quhet Rruga e Arbërit?

- Ky është një ndër segmentet më të vështirë, ku nga kthesat e shumta ka pasur dhe mjaft aksidente. Unë shpreh bindjen se kjo është pikërisht ajo që në media quhet Rruga e Arbërit. Kanë filluar punimet, pikërisht këtu, që të reduktohen sadopak pjesët e vështira. Pastaj është i vetmi segment në të gjithë trasenë e e kësaj rruge që shfrytëzohet qysh tani, ndaj dhe punimet kanë nisur këtu. Unë, si specialist i rrugëve, shpreh bindjen se ky projekt që po ndërtohet sot është një segment i rrugës aq të përfolur në media si Rruga e Arbërit. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe, që vetëm në lotin 3, në një distancë prej 5 kilometrash, 3 kilometra është trase e re. Mjafton të hedhësh vështrimin e të shohësh këto skarpate të larta që po gërmohen dhe pastaj fjalët e tjera janë të tepërta. Po të ishte një ristrukturim i rrugës ekzistuese, nuk do të kishim një projekt teknik të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, nuk do të devijonim kaq shumë nga ajo ekzistuesja dhe së fundi nuk kishim pse të zgjeronim trasenë kaq shumë sa po zgjerohet aktualisht. Besoj se ka ardhur koha që për dibranët kjo nuk është më një ëndërr, por një realitet. Traseja e rrugës së tyre po zgjatet dita-ditës drejt Tiranës. Nuk do të jetë e largët dita kur Dibra dhe Tirana do të jenë fare pranë njëra-tjetrës. Dhe ky është një fakt që po e shikojnë të gjithë dhe besoj nuk ka nevojë për komente të tepërta.

Në këtë segment po punojnë tetë kompani vendase. Sa është fondi dhe nga është dhënë ky fond për këtë pjesë rruge?

- Është abuzuar shumë në media se gjoja fondi për këtë segment rruge është 17 milionë euro. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Fakti është krejt ndryshe dhe ja se si. Vlera fituese e tre loteve të këtij segmenti është 972.407000 lekë pa TVSH ose 7.780.000 euro. Me TVSH është 1.166.8000 lek ose 9.335.000 euro. Ky fond është dhënë nga buxheti suplementar i shtetit, ndryshe nga shumë rrugë që financohen nga donatorë të huaj.

Sipas projektit teknik a kemi të bëjmë me një rrugë vërtet bashkëkohore?

- Kjo rrugë po ndërtohet me dy korsi. Është një rrugë me parametra bashkëkohorë. Vija ndarëse midis dy korsive është 3.5 metra. Pra, gjerësia e rrugës është gjithsej 9 metra e asfaltuar, duke llogaritur dhe dy bankinat anësore.

Kryesore është se kemi të bëjmë me një rrugë të kategorisë së parë, që në këtë zonë as që është ëndërruar ndonjëherë. Përqindja e malores është aq e ulët, sa nuk ndjehet fare. Ajo eliminohet duke gërmuar kodra të tëra, duke krijuar skarpate të larta mes dy anëve të rrugës, duke hapur ushqe, që në pamje të parë, nga larg, të krijojnë përshtypjen e ndonjë tuneli të madh.

Deri tani, çfarë volumi pune është kryer dhe po të vazhdohet me këto ritme, kur mund të përfundojë ky segment?

- Edhe pse kushtet atmosferike të motit kanë qenë të papërshtatshme, kjo nuk i ka penguar firmat që të punojnë gjatë gjithë kohës në trase. Deri tani janë gërmuar e zhvendosur nga tetë kompanitë që punojnë mbi 230.000 m^3 dhé e shkëmb. Në fakt, kontrata është që ky segment të përfundojë në fund të vitit, por kemi problem se, në qoftë se do të fillojmë shtresën e asfaltit në vjeshtë, atëherë do të kemi të bëjmë me probleme teknike, pasi asfalti nuk shtrohet në stinë të ftohtë. Temperatura duhet të jetë e lartë që të punohet me shtresën e asfaltit. Gërmimet duhet të përfundojnë në muajin prill. Mbushja mund të bëhet më shpejt, pasi vetë struktura e tokës është e tillë që nuk ka nevojë për shumë mbushje. Më shumë do të na kushtojnë kohë veprat e artit, të cilat janë të shumta në këtë segment. Deri tani jemi mjaftuar vetëm me vendosjen e disa tombinove. Megjithatë, ende jemi herët për të folur për fundin e këtij objekti, por po të punohet me këto ritme, them se e realizojmë objektivin.

Kompanitë që po punojnë a kanë hasur pengesa gjatë punës dhe të çfarë natyre kanë qenë?

- Pengesat kanë qenë nga më të ndryshmet. Në radhë të parë, vetë struktura e tokës nuk ishte llogaritur sipas projektit, pasi kjo nuk dihej se si ishte në thellësi. Është gërmuar në mbi 20 metra thellësi nëpër usekë dhe mbi 30-40 metra skarpate. Probleme ka pasur dhe me vetë banorët për kompensimin e pronave, megjithëse është ngritur dhe grupi i punës. Problem kemi pasur tek useku i Krajkës, ku sipas banorëve sipër tij ka qenë vakëf, varre të vjetra. Për këtë është bërë zgjidhja teknike, ku dhe është miratuar edhe në Këshillin Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Edhe në këtë usek kemi filluar punë dhe me mjetet që disponojmë them se do ta hapim shpejt këtë trase. Kompania tjetër "Delia Grup" dhe "Eurald" kanë pasur probleme të shpronësimeve në Peladhi dhe pikërisht tek parcela e mbjellë me drurë arre. Sot pothuaj janë zgjidhur këto probleme.

Nga është marrë fuqia punëtore që po punon dhe si bëhet trajtimi i tyre?

- Të gjitha kompanitë që punojnë sot në trasenë e Rrugës së Arbërit kanë punonjës (specialistë) me kontratë, të cilët trajtohen me kushte të mira, me hotel si dhe me ushqim.

Për këto kategori kompanitë paguajnë dietë ditore përveç pagës. Na është nevojitur që të marrim dhe punëtorë të tjerë vendas. Këto janë marrë në bashkëpunim me komunat përkatëse ku kalon traseja e rrugës. Këta punëtorë, që në fakt kompanisë i nevojiten, edhe pse nuk janë specialistë shërbejnë vetëm për sigurinë rrugore, për të kontrolluar lëvizjen e makinave dhe këmbësorëve, gjë që është e shumtë. Them me bindje, se po të mos kishim siguruar rrugën me këto punonjës, do të kishte dhe aksidente, gjë që tek ne as ka ndodhur dhe as do të ndodhë ndonjëherë, pasi dhe instruktimi teknik nga inxhinierët bëhet shpesh.

Pas përfundimit të këtij segmenti a mund të dijë lexuesi më shumë për projektin teknik të segmentit tjetër të kësaj rruge, atë Bulqizë-Tiranë, segment ky që është dhe më i vështiri?

- Po punohet për projektin teknik dhe shpreh bindjen se do të përfundojë shumë shpejt. Brenda tremujorit të fundit apo dhe me fillimin e vitit të ardhshëm them se dhe pjesa tjetër që fillon në Bulqizë përfshi këtu dhe tunelin e Qafës së Buallit me distancë 800 metra linear dhe deri në Urën e Vashës, mund të përfundojë tenderimi. Ka përfunduar projekti teknik për segmentin tjetër nga Ura e Çerenecit në Gjoricë dhe pritet të bëhet tenderi shumë shpejt. Atëherë do të binden të gjithë se traseja e Rrugës së Arbërit zgjatet drejt Tiranës dhe nuk mund ta ndalojë askush.

Brenda tremujorit të fundit apo dhe me fillimin e vitit të ardhshëm them se dhe pjesa tjetër që fillon në Bulqizë përfshi këtu dhe tunelin e Qafës së Buallit me distancë 800 metra linear dhe deri në Urën e Vashës, mund të përfundojë tenderimi. Ka përfunduar projekti teknik për segmentin tjetër nga Ura e Çerenecit në Gjoricë dhe pritet të bëhet tenderi shumë shpejt. Atëherë do të binden të gjithë se traseja e Rrugës së Arbërit zgjatet drejt Tiranës dhe nuk mund ta ndalojë askush.

Ne foto: Shaban Bitri

Ne foto: Pamje nga punimet në Rrugën e Arbërit

Shkup - Nga manifestimi për më të mirët "Në botën e suksesit"

Mirënjohje edhe për Komunën e Dibrës së Madhe

Në Sallën Universale" në Shkup parmbrëmë u mbajt manifestimi me moton «Në botën e suksesit-2008» në organizim të «Detla-Pres Marketing' dhe në bashkëpunim me "Stars Media".

Qëllimi i këtij promovimi është që të identifikohet dhe njihet kontributi i individit, institucionit, kompanisë ose organizatës e cila,në vitin 2007 ka ndërmarë ativitete të cilat opinioni i ka vlerësuar pozitivisht për të mirën e përgjithshmedhe që kanë lënë gjurmë në kohë.

"Delta-Pres Marketing" realizoi disa sondazhe për të arriturat në sektorin e biznesit, aksionet e individëve dhe institucioneve, për promovimin dhe zhvillimin në lëmin e ngritjes së vetedijes nacionale, në sferën sociale, në institucionet shtetërore, në sektorin shtetëror, vetëqeverisjen lokale,zhvillimin e arsimit,artit, vullnetarizmit, sportit dhe politikës.

Mirënjohje iu dhanë Qeverisë së Maqedonisë për realizimin e programit "Maqedonia-vend i informaticientëve", Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujëravepër përparimin në bujqësi dhe në pyllëzimin e pyjeve të djegura, Ministrisë për Punë dhe Politikë sociale,për hapjen e kuzhinave publike, për suksese në fushën e filmit dhe të restaurimit të objekteve kulturore dhe shuma firmave dhe individëve në fushën e biznesit,kulturës,sportit dhe përsonave me aftësi të kufizuara.

Në sferën e vetëqeverisjes lokale si komuna më të suksesshme mirënjohje morën Komuna e Ilindenit , Dibrës së Madhe ,Kumanovës, Radovishit dhe Krushevës.

Me rastin e dhënies së mirënjohjes për komunën e Dibrës së Madhe në këtë manifestim, u tha se:" Komuna e Dibrës së Madhe brënda tre vitesh ka arritur që nga një komunë e falimentuar me një buxhet vjetor prej 120 mijë euro dhe me borxhe të trashëguara prej 700 mijë euro, ka hy në fazën e dytë të decentralizimit me grupin e parë të komunave. Ka arritur të kthejë 80 përqind të borxheve. Në vitin 2007 ka realizuar një buxhet mbi 2 milionë e 100 mijë euro, ndërsa për vitin 2008 është planifikuar një buxhet prej 4 milionë e 200 mijë euro.

Në këtë periudhë tre vjeçare janë bërë investime në Sistemin e ujitjes, poligone sportive, rekonstruksion në dy shkolla dhe një ambulancë fshati, rekonstruksioni i Hamamit të Qytetit dhe i një shtëpie karakteristike dibrane, ndërtimi i Qendrës për sportet ujore, ndërtimi dhe asfaltimi i 31.640 metra katrorë, pllakëzimi i 24.000 metra katrorë trotuare, instalimi i 5.520 metra katrorë kanalizim për ujërat e zeza dhe 2.840 për ujërat atmosferike, ndërtimi i godinës së re të komunës, ndërtimi dhe asfaltimi i Bulevardit "Ilyria", organizimi i manifestimeve kulturore "Ditët e Kulturës"-Dibra 2007/2008, Regata ndërkombëtare në kajak dhe kanu, turnetë në futboll dhe karate, miratimi i 12 planeve detale urbanistike dhe në procedurë e sipër 6 plane detale urbanistike dhe Plani gjeneral urbanistik.

Duhet t'i çmojmë sukseset e Argëtim Fidës, kryetarit të Komunës së Dibrës së Madhe dhe të stafit të tij. Ata sonte gjenden në botën e suksesit".

Argëtim Fida gjatë marjes së mirënjohjes,deklaroi se:"Falenderoj familjen dhe prindërit e mij,alenderoj stafin tim në komunë, Këshillin e komunës, intelektualët që më ndihmuan dhe tërë qytetarët. Kjo është një nxitje që në pjesën e mbetur të mandatit të angazhohemi edhe më shumë që Dibrës së madhe t'ia kthejmë dinjitetin dhe që dibranët të jetojnë në një ambient urban të ngjashëm me atë në Evropë".

R.TORTE

Reportazh

Asfaltimi i rrugës e gjallëron Bohmovën

Gatishmëri për ndërtimin e kësaj rruge

Mersim Marku, gjykatës dhe kryetar i Këshillitfamiljar të Fisit Marku dhe bashkëfshatari i tij Haki Marku më sollën sihariqin e nismës për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës nga Dibra e Madhe deri në fshatin Bohmovë në gjatësi prej 3 mijë e 800 metra. Siç thanë ata tashmë është gati edhe projekti për ndërtimin e kësaj rruge, është hapur xhirollogaria dhe disa nga mërgimtarët që jetojnë e punojnë në SHBA fillimisht kanë akorduar 50 mijë dollarë.Pritet ndihma nga mërgimtarët e tjerë dhe nga pushteti vendor.

Çezma te livadhet e Bohmovës

Pamje e Kullës së Salë Markes

Pamje e rrugëve me kalldrëme të Bohmovës

Në emër të Këshillitfamiljar të Fisit Marku mërgimtarëve dibranë në SHBA është dërgur edhe një letër për mbështetjen e tyre financiare në ndërtimin dhe asfaltimin e kësaj rruge. Në këtë letër mes tjerash shkruan:" Ne Market që jetojmë në Dibër kërkojmë mirëkuptim vëllazëror për idenë që duam ta realizojmë.Jemi të bindur se ju keni vullnet të mirë për vepra të mëdha me interes madhor familjar. Kemi gjakun, trungun,gjenezën, emrin familjar,historinë familjare. Edhe në ditët tona gëzojmë respekt në "Nëntë Malet e Dibrës".Kemi detyrë njerëzore e familjare, që këtë fshat tërësisht tonin me vlerë historike për familjen dhe kombin, ta bëjmë të pavdekshëm. Me ndihmën edhe tuajën dëshirojmë që fshatin Bohmovë ta shndërojmë në fshat të zhvilluar e turistik për familjet tona dhe për tërë qytetin dhe për gjeneratat e ardhshme. Me kontribut të përbashkët dëshirojmë tu dalim zot vlerave tona familjare. Jeta është e shkurtër ndërsa me vepra madhore emri bëhet i pavdekshëm. Shembull më i mirë për këtë është vllay ynë Vehbi Marku amanetin e të cilit e kryen djemtë e tij në vitin 1975, duke e ndërtuar çezmën te livadhet pranë varrezave të të parëve tanë, ndërsa Jonuz Marku investoi në rregullimin e Vorrit të Hasimes. Në livadhet në të hyrë të fshatit, tashmë tradicionalisht vijnë në ekskursion nxënësit e shkollave, grumbullohen qindra persona të të gjitha moshave të familjeve familjet të Fisit Marku, për të kremtuar sëbashku edhe Ditën e Verës, Shëngjergjin, 1 Majin, ku ne tingujt e muzikës, me këngë e valle dhe aktivitete sportive.Kjo nismë e jona mbështetet edhe nga Fisi Dema i fshatit Shushicë, nëpërmjet aktiviteteve të Bajram dhe Besnik Dema, në fshatin Taranik nëpërmjet Beqir Markes, Sami Markes, dhe familjeve dibrane Mullarexha, Çikri dhe Ame e të tjera, në afërsi të tokave të të cilëve kalon kjo rrugë".

Fshat me bukuri magjepëse

Më datë 14 maj 2008 me shoqëruesit e mij Mersim dhe Haki Marku vendosëm të shkojmë e ta vizitojmë këtë fshat të bukur por të braktisur, që ndodhet përbri kufirit me Shqipërinë dhe buzë lumit Drini i Zi.

Rruga aktuale nga Dibra gjer te fshati Bohmovë nuk është e asfaltuar.Atë e mirëmbajnë vetë banorët e këtij fshati me aksione vullnetare duke e shtruar me zhavor.Mbi fshat janë varrezat ku mes tyre dominojnë Varri i Mirë dhe Varri i Salë Markes, i figurës së shquar të këtij fshati dhe të Dibrës e më gjerë.Poshtë dhe rreth varrezave shtrihen zabelet, livadhet dhe fusha pjellore.Ajo që të bie në sy janë bukuritë magjepëse të këtij fshati,plot bukuri dhe burime ujore. Të bien në sy shumë shtëpi të shkatërruara dhe disa që ende i sfidojnë kohës. Mes tyre është edhe Kulla e Salë Markes, dy katet e së cilës u shkatërruan gjatë tërmetit të vitit 1968.

Në kohën e lulëzimit të tij fshati Bohmovë kishte me dhjetëra shtëpi, shkollën dhe xhaminë e fshatit.

Ajo që të mahnit duke shëtitur nëpër këtë fshat është infrastruktura e tij e dikurshme, që pasqyrohet nëpërmjet kanalit për ujitjen e ngastrave, çezmet dhe puset në oborret e shtëpive, rrugët me kalldërme dhe oborret e shtëpive të shtruara me kalldërme. Siç tregojnë ish banorët e këtij fshati, rrugët dhe oborret e shtruara me kalldërme shndritshin nga pastërtia.

Salë Markja dhe lavdia e Bohmovës

Salë Markja (1789-1869), është figurë emblematike e Fisit Marku, e fshatit Bohmovë që ishte edhe çifliku i tij, e Krahinës së Dibrës me karakter kombëtar, është një nga figurat qëndrore e lëvizjes kombëtare shqiptare kundër pushtimit osman. Për urtësinë, dinjitetin, guximin dhe veprimtarinë e tij në Nëntë Malet e Dibrës, populli ia dha nofkën "Dhelpra e Kuqe".Për kontributin e tij në dobi të atdheut, Shteti Shqiptar në vitin 1993 e dekoroi me "Urdhërin për veprimtari patriotike të Klasit II", me motivacionin "Si luftëtar e udhëheqës popullor që dha një kontribut të shquar në luftën kundër pushtuesve osmanë". Salë Markja u dallua edhe për karakterin e tij human dhe aftësinë e rregullimit infrastrukturor të fshatit Bohmovë, duke ndërtuar që në atë kohë edhe kanalin ujitës të gjatë 7 kilomatra, për ta sjellë ujin nga Drini i Zi deri në fshatin e tij.

Fshati që shpreson në ringjallje

Shpërngulja e banorëve të fshatit Bohmovë filloi në vitët 50 të shekullit të Njëzetë.Kjo u bë për arsye ekonomike,të rënies së zhvillimit bujqësor, të papunësisë,të hapjes së vendeve të punës në qytetin e Dibrës së Madhe dhe sidomos për shkak të rrëshqitjes së tokës pas ndërtimit të Liqenit artificial të Dibrës së Madhe për HC "Spila" në vitin 1969.

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës do ta rringjall këtë fshat të begatë,sepse shumë ish banorë mendojnë të ngrenë familjet me bletë, stallat me bagëti dhe intensifikimin e punimit të tokave pjellore bujqësore, përbri të cilave rrjedhin burimet ujore të pashterrshme, duke mos përjashtuar as edhe rindërtimin e shtëpive dhe përtëritjen e bahçeve me perime dhe pemë frutore.

Ndërtimi dhe asfaltimi i kësaj rruge do të shërbejë edhe si arterie lidhëse e një pjese të Kojnarës së Re, Fushës ë Dibrës së Madhe , Trapit të Dacit, Të fshatrave Taranik e Shushicë. Kjo do të mundësojë arritje më të lehtë dhe më të shpejtë te të gjitha tokat e punueshme, punimin më efektiv të këtyre tokave dhe vjeljen dhe sjelljen në shtëpi të prodhimeve bujqësore që shquhen për nga cilësia dhe sasia.

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për të arritur në këtë fshat të bukur me plot resurse bujqësore dhe turistike, me siguri do të jetë ugur i mirë për gjallërimin e këtij fshati, sepse rruga gjithnjë është dhe mbetet promotor i zhvillimit.

Rexhep TORTE

Me folë dibranisht

Nga **Agron TUFA**

Më folë dibranisht nuk don të thotë medoemos të flasësh në dialektin e Dibrës (nga është vetë autori); dibranishtja si gojëfolje e nëndialektit gegë, me arealet e saj, sugjeron vetëm efekte ekzotike gjuhësore dhe të tilla i gjen në çdo krahinë shqiptare, sa më në thellësi të shtyhesh. Përfytyroni një nga figurat më qendrore të mitit tonë kombëtar, nipin e Palit, birin e Gjon Kastriotit, Gjergj Kastriot – Skëndërbeun nga Sina-Kastrioti i Dibrës, duke folur dibranishten e shekullit XV... Mjafton kjo për të rrëzuar përceptimet ksenofobike ndaj gojëfoljeve dialektore të botës shqiptare, si paragjykime mendjelehta të lindura shumë vonë, pas ujdisjes së gjuhës standarde.

Me folë dibranisht, unë nënkuptoj një cilësi ligjërimi krejt të veçantë që përbën jo mbështjelljen fonetike të folësit, por, para së gjithash, botën e tij filozofike, estetike dhe psiko-mentale. Këto cilësi të ligjërimit dibran janë vënë në dukje shumë më herët se ky shkrim, nga të huaj dhe shqiptarë, por unë po i kthehem sot këtij vlerësimi për dy arsye, që nuk hyjnë si rëndom në sindromën e krenarisë tyryfile – karakteristikë shumë e përhapur tejkund nëpër arketipin krahinor të shqiptarëve. Arsyeja e parë është fakti që ekzistenca ime, e veprimtarisë time intelektuale e shpirtërore është tërësej e varur nga gjuha, në të gjitha shfaqjet e saj dhe, arsyeja e dytë që më ka mahnitur përherë, është lehtësia dhe eleganca në përçimin e mesazhit, sado e acaruar qoftë situata. Pra, kemi të bëjmë me qasje operative *terapeutike* ndaj ligjërimit, që me mençuri shkapërcen tensionet kritike duke fashitur patetikën e konfliktit, pa përfunduar situata në tragjedi. Dhe kjo qasje ndaj ligjërimit është, parasëgjithash, arti fluid i zërit të logjikës dhe arsyes, para rrëmbimit zemërak të kokave të nxehta, jo pa doza humori shtendosës. Një mënyrë e tillë, e tërthortë e artikulimit të të vërtetave të mëdha e të vogla, është gjithnjë apel për vetëpërmbajtje, apel për për të medituar më gjerë mbi dukurinë, për të mos u yshtur në veprime të nxituara ku pasojat janë të pakthyeshme. Sepse duke nisur qysh nga forma figurative e kumtimit të mesazhit dhe kohës që i lihet recepientit për "ta tretur", "zbërthyer" apo "interpretuar", kalon një kohë, përgjatë së cilës, psikika e njeriut përballet me një punë operacionale logjike e përjetuese, e mjaftueshme për të rishikuar një raport harmonik të marrëdhënieve të njeriut me botën, të marrjes në hesap të argumentit dhe motivit të "tjetrit" me gjithë hapësirën e supozuar të "lirisë së tjetrit". Sado i padurueshëm qoftë njeriu, ai, tekefundit, nuk është krejt indiferent përballë ndjenjës së drejtësisë, fajësisë, tolerancës, të cilat konstruktojnë së brendshmi thelbin e marrëdhënieve të tij individuale dhe shoqërore përballë të tjerëve. Gjykim shoqëror i sociumit ku jeton idividi është një instancë shumë e përfillshme dhe shpesh shërben si gur themeli për moralin njerëzor të bashkëjetësës dhe shembullit të mirë apo të keq.

Por ku qëndron sekreti i "kuvendimit dibran" dhe çfarë e bën atë të ketë një potencial *përtejgjuhësor* në funksionin e komunikimit? Mendoj se vetë struktura e ngjizjes, vetë arti i thurjes së mesazhit, vetë intenca që provokon te dëgjuesi një përtypje të ngadaltë dhe një përgjigje jo të shpejtë, i ka të ndërkallura këto "sekrete". Kuvendimi dibran nuk është formalisht i drejtëpërdrejtë; ai vjen i veshur figurativisht, sidomos kur zotër të tij janë mjeshtra të qëmotit, apo bartës që e kanë trashëguar tradicionalisht. Nga pikëpamja semiotike është një komunikim i *referentit* përballë *recepientit* që ekzistojnë në një *situatë* të njohur, të përbashkët. Përndryshe anët e komunikimit nuk do të orientoheshin me konvencionet dhe *marrëveshja* nuk do të realizohej. Simbolika, alegoria dhe analogjia i japin këtij kuvendimi një dimension filozofik, psikologjik, estetik dhe, së mbrami, etik dhe didaktik.Të ushtruarit ndër shekuj, e ka bërë këtë ligjërim një aparaturë të koklavitur e tepër të hollë, ku folësi dhe dëgjuesi përfshihen në një situatë të tendosur vigjilence dhe përfytyrimi në lidhje me kontekstin e kuvendimit. Pra, puna mendore, e pashkëputur nga etika shoqërore, të dikton një pozicionim të kujdesshëm, çka përcakton një dinamikë të gjallë në evolucion të përhershëm. Modelet e këtij ligjërimi, thamë që janë të lashta e të përpunuara vazhdimisht dhe, në fakt, struktura e tyre e hapur, të lejon si pasurimin, ashtu edhe harrimin. Por ky ligjërim alegorik nuk duron instanca dembele (folësin dhe dëgjuesin/auditorin). Në rast të kundërt mekanizmi i tij të përjashton.

Faktet dhe argumentet në komunikimin e këtij ligjërime nuk thuhen trashë e drejtëpërdrejtë: ato skicojnë me art dhe shije të hollë një situatë të tërthortë, të nginjur me imazhe dhe konvencione alegorike, me qëllim që ndikimi real të receptohet i përkthyer në gjuhën pragmatike të situatës, çka sjell shpesh një ripozicionim ndaj çështjes apo dhe ndryshim të pikëvështrimit. Ky aparat i ndërlikuar dhe tepër efikas në artin e kuvendimit shpërthen në paravoli, skica, analogji duke u ushqyer me hapësira të begata imagjinare, me vizione që rrokin tërësinë e dhe perspektivën e situatës. Për këtë arsye ata që nuk e njohin këtë art apo ata që janë të ngathët e shohin veten të flakur jashtë në mënyrë qesharake. Etika dhe mendjemprehtësia në kuvendimin alegorik dibran operon duke parashtruar jo qitjet me pistoletë nga një distancë e afërt, por goditjet e largëta kilometrike me top. Sa më virtuoz, hermetik apo i maskuar të jetë thelbi i paravolisë alegorike, aq më befasues dhe tronditës është mesazhi në fund, i cili, gjithmonë, synon "çarmatosjen" e kundërshtarit nga "urtësia e keqe". Instrumentari i këtij aparati të sofistikuar ka një "shëndet" gjithëherë bashkëkohor, në çdo situatë, mjafton që kuvendimi alegorik të gjejë magun, ustain e tij. Prandaj nuk mund të flitet për "vjetërim" të metodës "dialogjiste" të kuvendimit dibran, sado i supermodernizuar me teknologjinë e informacionit të jetë aktualiteti. Ndoshta ky është një tipar që nuk varet nga gjendja diakronike apo sinkronike e gjuhës, por nga aftësia për t'u përshtatur me shenjat dhe për t'u bërë atyre një shpërndarje e rishpërndarje funksionale. Këtë mendim do ta përforconin materialet e bollshme, nëse do të kundroheshin sipas një linje koherente historike, me ndryshimet shoqërore, kulturore apo politike.

Ja për shembull, një model i fundshekullit të XIX, kur dobësohet roli qëndror i ndikimit dhe vendimeve të "nand maleve" dhe kur përparësinë e përfaqësimit e marrin elitat religjioze, përkatësisht hoxhallarët dhe shehlerët.

Në një mbledhje të krerëve të Nandë Maleve, teqeve dhe Oxhaqeve të Dibrës, para se me fillue kuvendimi, para parisë së tubueme nën një lis të moçëm del një plak, i cili në një dorë mbante një thikë të madhe, ndërsa me dorën tjetër tërhiqte për brirësh një dash të madh leshgjatë.

Pasi e shtrin dashin në rrethin e burrave, plaku çon thikën në gabzherrin e tij dhe, para se ta therrë, bën një ritual paraprak, duke i kënduar dashit një këngë me këto fjalë:

"Dash, dash, o i majri dash!
Pate ni çoban dallash!
M'i ke brinat dymdhet pashë!
M'a ke leshin si mundash!
M'a ke kokën për shehlerë!
M'i ke shpatllat për bejlerë!
M'a ke bishtin për asqerë!
çfarë t'teproje – për ne t'qerë...

Kush e ka parasysh kulturën tradicionale dibrane të ndarjes së nishaneve të berrit, sipas meritave dhe respektit, e kupton farë mirë se simiotika e këtij gjesti, gjoja ritualor, është një alegori e përkryer e shpërndarjes së nishaneve sipas rëndësisë dhe meritave, duke propozuar një hierarki të re në parinë e Dibrës. Sepse që në fillim, plaku, duke iu drejtuar dashit të flisë, qorton çobanin e tij (nënkpto: të kopesë/grigjës; dashi është prijësi i kopesë dhe kopeja përfshin edhe konotacionin simbolik të popullit në kuptimin fetar, ku prijës i grigjës, bari i popullit është prifti apo hoxha/shehu). Plaku e qorton çobanin e kopesë, sepse ai (bariu), nuk i ka pri mirë grigjës (popullit), ngase ka qenë një "çoban dallsh", i gabuar në rrugën e interesave të grigjës. Mandej, kokën me të cilën nderohet personi më i rëndësishëm, "kryet e vendit", ai ia jep shehlerëve, pra bariut të mirë që është udhëheqës shpirtëror i popullit. Apeli alegorik lexohet kështu: situata nuk është më e tillë, që të udhëheqin krerët e maleve, çka çon në radikalizimin e konfliktit; tani udhëheqëse duhet të jetë elita fetare që ruan shëndetin shpirtëror dhe largon popullin nga gjakderdhja. Prandaj dhe bejlerët – "m'i ke shpatullat për bejlerë" - (nënkupto: krerët e maleve dhe kryet e oxhaqeve), kalojnë tanimë në plan të dytë, gjithësesi, të respektuar në hierarki. Konfigurimi i hierarkisë, më poshtë, vijon të jetë i ndjeshëm dhe të tregojë respektin dhe rëndësinë e luftëtarëve, duke iu dhënë atyre një prej tre nishaneve dhe duke përcaktuar rolin e dorës së tretë në hierarkinë shoqërore ("m'a ke bishtin për asqerë"). Dhe së fundi, pas tre niveleve të hierarkisë, vjen vegjëlia, populli i shumtë, tashmë i përfaqësuar nga shprehësit e interesave të tyre, i bindur të ndajë hisen e asaj "çfarë të teprojë" nga zotësia dhe puna e elitave të tij.

Ndonëse mund të bartë diç të sforcuar, prapëseprapë një analogji të tillë alegorike më pëlqen ta përqas me skemën hierarkike që ndërton filozofi i lashtë grek, Platoni, ne veprën e tij "Republika" kur ndan tre nivelet e shpirtit: shpirti dëshirues, në nivelin e barkut; shpirti guximtar, që synon të luftojë, të zotërojë, të angazhohet për një çështje a për një tjetër, i cili ndodhet në nivelin e diafragmës; shpirti i arsyeshëm, i cili ndodhet në kokë. Secili nga këto tre nivele është i domosdoshëm, por ato përbëjnë një hierarki. Njëlloj ndodh edhe me qytetarët në qytetin-shtet. Fshatarët dhe artizanët janë në nivelin e dëshirës, luftëtarët, në nivelin e guximit; nëpunësit në nivelin e urtësisë. Edhe tek ndarja që bën plaku dibran, konfigurimi i niveleve përbën një hierarki të qartë, por jo të shpirtit individuar, por të "shpirtit shoqëror". Kësisoj niveli i dëshirave të vegjëlisë nuk mund të dalë përballë guximit të luftëtarëve, përpara fisnikërisë së krerëve dhe dyerve të mëdha dhe as përpara urtësisë së barinjve shpirtërorë.

Alegoria e kuvendimit dibran është njësoj armë e efektshme edhe në kohët e reja. Le të marrim një shembull në qershorin e vitit 1991, kur një ish-inxhinjer, politikan i Partisë Socialiste (deri më 10qershor 1991 – ish-PPSH), takohet me zgjedhësit dhe u shpjegon atyre platformën e partisë së tij, pas ndryshimit të emërtimit. Ngrihet një plak i thjeshtë dibran dhe me pyetjen e tij, në dukje krejt larg nga problemi, shkakton këtë situatë:

-Or bir, i drejtohet ai kandidatit për deputet. - Ta zëmë se kemi një kriminel që ka vra njerëz – fëmijë e gra, burra e pleq, me një fjalë, një gjakësor i vërtetë. Ky njeri kapet, drejtësia i gjen provat e krimit, i fakton, dhe vetë krimineli i pranon krimet, pa u penduar. Mbas dy ditësh lihet gjyqi, caktohet prokurori dhe pritet dënimi. Desha me e ditë prej teje, or gjalë, a duhet të dënohet me vdekje ky kriminel?

- Sigurisht duhet të dënohet me vdekje, i përgjigjet ish-inxhinjeri, kandidat për deputet, dhe shton duke përforcuar: - përderisa e ka pranuar krimin, pa reflektuar pendesë.

- Po mirë, thotë plaku, - po nëse gjatë kohës së hetuesisë, ky kriminel, duke shfrytëzuar hapësirat ligjore të të drejtave njerëzore ka aplikuar për ndërrimin e emrit dhe një ditë para gjyqit, atij i vjen pashaporta e re, tashmë me një emër tjetër, a duhet të dënohet ky njeri?

- Sigurisht duhet të dënohet, i thotë kandidati.

- Po si mundtë dënohet pra, sepse krimineli kundërshton me të drejtë: ai thotë se drejtësia po gabon, ngase gjithë hetimet, gjithë prova e fajësisë i takon një personi tjetër që quhet Nazif, ndërsa ai tund pashaportën dhe dëshmon para gjyqtarëve se quhet Robert, jo Nazif. Keni ç'keni me Nazifin, thotë ai, nuk më intereson, shkoni e kapni Nazifin: unë jam një person tjetër, quhem Robert dhe nuk marr përsipër fajet e Nazifit! Kështu që, zotërinj gjyqtarë, ju s'keni të drejtë ta përlyeni emrin e nderuar e të pastër të Robertit me fajet e kriminelit Nazif.

- Jo, kundërshton kandidati: - s'ka rëndësi ndërrimi i emrit, rëndësi ka identititeti i personit që ka kryer krimet, të cilat janë dëshmuar se i ka kryer ai, Roberti, që para një dite quhej Nazif.

Ndërsa loja vazhdonte me këtë kurth dhe lojë spekulative, alegoria ishte më se e qartë dhe, në fakt, të pranishmit po shkuleshin gazit. I vetmi që nuk e kuptonte kurthin ishte deputeti, i cili me zell përpiqej t'i shpjegonte këtij plaku "naiv" procedurën e ndëshkimit të fajtorit real, pavarësisht pehlivanllëqeve të tij me ndërrimin e emrit.

- Rëndësi ka fakti i padyshimtë që identifikon vrasësin kriminel me viktimat – të tjerat s'kanë rëndësi! – bërtiste hareshëm kandidati, duke e marrë gazin e përgjithshëm si reagim ndaj naivitetit këmbëngulës të plakut.

Atëherë ky plak "naiv", e braktis lojën dhe e formulon ndryshe pyetjen:

- I kujt partie je ti, or gjalë?

- I Partisë Socialiste.

- Ti, filani, filani, filani e filani... (plaku numëroi thuajse gjithë kryesinë e partisë), si e kishi emrin e partisë para një javë?

- Partia e Punës së Shqipërisë.

-Po ho mër i bekuem, mos na lodh ma teqe... Ky osht aj Nazifi e Roberti qi ta pata llafin, ër deshamajr!".

Ka edhe një rast tjetër, po me situatën politike, atë të zgjedhjeve në vitin 1997. Siç mbahet mend, Partia Demokratike atë vit hyri shumë inferiore në zgjedhje, me një bankrot moral e reputacion të dëmtuar, pas trazirave, shkatërrimeve e vrasjeve të '97-ës. Demokratët e degës së Dibrës e kishin shumë vështirë, jo të bënin fushatë, por thjesht të hynin në bisedime me popullin.

(Vijon në faqen 12)

Shënime udhëtimi nga Kulla e Pizës te kullat e Dibrës

Nga **Dr. SELMAN MEZIU**

Te shfletosh dosjen e nje udhetimi, esh te kenaqesi shpirterore. Te vizatohen, peisazhet, ngjarje, njerez, te cilet te tregojne diçka, e me pas futesh ne rrugicat e monopatet e saja e behesh plotesisht i tyre. Imagjinata merr udhe e bashke me te edhe fizikisht lodron, rrembehesh, emozionohesh.

Pritje e dëshpëruar

Mengjez i laget, qiell i ngarkuar me re te cilat bejne levizje kaotike ne hapsiren e pafund te tije. Udhetim i qete ne kete autobuz komod nga Firencia ne qytetin e Pizes. Kulla e seciles eshte nje margaritar arkitektural e historik e ku astronomie fizikanti Galileu kreu eksperimentin e famshem te renies se lire te trupave.

Hyme ne aroport, ai gumzhine nga njerez te shumte. Kalojme ne kontrollin e sigurise duke vene ne kutia kauçuku gjitheçka metalike por edhe xhupin, jelekun rrypen e me duart larte kalojme ne nje dere. Asnje sinjal. Riveshemi e perpiqemi qe te veme gjitheçka ne vendin e vete. Te gjitha keto veprime jane dhurate e tragjedise se njembedhjete shtatorit dymije e nje te kullave binjake te Njujorkut. Veper e te ciles i dedikohet mjekroshit milardier Bin Laden nga Arabia Saudite.

Ne sallen e pritjes qindra njerez. Degjojme nje ze te qete qe del nga artopolantet i cili here pes her na thote ne italisht e anglisht: Eshte e ndaluar te pihet duhani! E pas nje heshtje te shkurter : posagjeret per Paris, Amsterdam, Frankfurt, Milano, Katania ne udhekalimet dy, kater, pese gjashte, tete.

Edhe pse kaluan tridhjete e pese minuta nga orari e nisjes sone asnje lajm. Nje djalosh i ri u afrua dhe pyeti se kur do te nisj avioni per Tirane: Nenpunesi i airoportit iu pegjegj, pasi beri disa veprime ne tastierat e nje kompiuteri te instaluar prane tije. Sepaku duhet te prisni tre ore. U degjuan si nje kor i drejtuar nga nje dirigjent ofshamat oh, oooh…. .

Disa humben oraret e varrimeve te dashureve, si ne Tirane e Vlore te tjere ato te operimeve ne spitale apo takimet ne zyrat e ndryshme. E me pas nga deshperimi rrodhen grupshrehjet: Keshtu e kane koken Shqipetaret. Ne kudo jemi te mallkuar si ne grupe por pse jo edhe si komb.

Gjithçka me okularin e mikroskopit

Koha e shendrruar ne bronx, kalonte, nderkohe ne benim nga nje here levizje pergjat salles se madhe ku vazhdimisht hynin e largoheshin njerez ne drejtime te ndryshme . Kur rikthehemi, nuk shohim bashkeatdhetaret. Nga shkuan, nga u zhduken?Morem informazion se kane shkuar ne katin e dyte, Ngjitemi. Mbreteronte nje heshtje varri. Te gjithe kokulur e te menduar, ne fytyrat e tyre lexohesh lodhje, merzitja e nje nervozizem ku tek disa ishte shprehur ne ngritjen e nje delli ne balle apo skuqjen e majes se hundes. Morem vesh se avioni do te nisesh pas gjashte oresh. Kjo shprehje ishte ajo fotokopia psikologjike e ketyre njerezve te pafate.

Ne kete salle te vetmuar, te diskreminuarit ne Shqipetaret filluam odisene e kontrollit te pashaporteve e te leje qendrimeve, ku nuk munguan perplasjet me policine, te cilet gjitheçka e shikojne me okularin e mikroskopit e imazhin e shqipetarit. Nje nuseje te re qe edhe kjo kthehej sepse kishte nenen shume te semure, i bene provimin e shkruarjes se ditelindjes, vendelindjes ngjyres se syve etj, i zbathen kepucet, i thane zgjidh floket etj e me ne fund i thane :Juve nuk jeni kjo qe paraqet fotografia ne pashaporte, kur te ktheheni nderroni ate. Komisioni prej kater policesh keshtu vendosi. Ajo u u largua e skuqur ne fytyre e lotet i rokolliseshin rreke ne faqet e purpurta e te njoma. Megjithate ajo shpreson ne thellesi te shpirtit se nenen do ta gjeje gialle. Te njejten gje pesoi edhe nje çift me nje femije te vogel shtate vjeç.

Keto lloje sjelljesh e veprimesh jane bere te zakonshme per gjithe posagjeret e emigrantet me kombesi shqipetare. Per policine, nepunesit e airoporteve e te vende ngarkimit te trageteve nje detyrim e nje metode pune e perditshme dhe e paharrueshme.

Limfa e jetës

Udhetojme ne nje furgon, prane meje Mersim Krashi. Nga dritaret shfaqet velloja e bores qe ka mbuluar gjitheçka, emocionuese me disrelievin e saj te formuar nga shtepi drure shkurre, kodra te embla, kurrize e lugina te cilat te parakalojne si pamjet ne nje ekran televisori. Syte na shkelqejne e ngarkohemi me emozione ngazellonjese. I gezohemi ketije udhetimi te kedshem e romantik

Koha kalon pa u ndiere kur i moshuari me jep me hollesi qe nga origina emrat e fisit Krashi, banues ne çidhen e Arras. Memoria e tij te ngjane me nje kasete vidio rregjistruese. Me lehtesi ndertoi pemen e stermadhe te shresezimit te familjeve.

Eshte nje dhurate shume e çmuar. Perfytyroi se si ka levizur limfa jete ne trungun e e deget e kesaj peme. Secili emer perben nje episod, nje ndeshje te pergjakshm. Vijueshmeria e kesaj mori degezimesh, tregon se si nje brez i trasmeton tjetrit, mjeshtrine e bujkut, te muratorit, i meson rrugen e kurbetit, se si perdoret pushka, mistria., çekiçi, shati, e mesa dhimbje e mundim lind e rritet femija.

Sa kaq ndodhemi ne Qafe Buall. Sa ngjarje te panumurta shtresezoen ne shekuj ne gjerdanin e saj. Ashtu si Veriu siç thone ka ministrine e tije edhe heroizmi i shkruar e pashkruar e ka ketu fillimin apo mbarimin ne trajte historie apo gojdhene.

Jane te epokes se Kastrioteve kunder turqeve, e me pas betejat e pergjakshme ndaj austro-hungarezve, serbeve te pa shpirte, bullgareve perandore, e mbyllen me luftrat kunder fashizmit italiane e gjermane. E mijera tonelatea krom, mermer molle, kumbulla e prodhime bujqesore e blegtorale etj kane kaluar ketu, duke mbartur me vete djersen, mundin e energjite fizike e mendore te minatorit, bujkut e intelektualit Dibrane. Jane hallka te nje zingjiri qe quhet Jete.

Klimë siberiane

Mikrobuzi i Maliq Lleshit leviz lodhshem edhe pse me gomat e reja ne asfaltin e dyfishte. Eshte akulli prej kater deri ne gjashte centimetra. Ai eshte i perqendruar mbi timon dhe veshtron i tensionuar shtresen e re shume te rrezikshme per te gjithe neve qe udhetojme. Peisazhi eshte mallengjyes. Makina qe kane rreshqitur e shtyhen per te rifilluar udhtimin. Te veshur trashe e me floket e bores qe sitet nga nje hapsire gri e hapur. Njerezit, ecin, shikojne e ngrene doren makinave, markave e targave te dryshme . per nje kalim nga kjo bote Siberiane, e eger, dritheruese, akullformuese ne kontaktet me qerpikete syve, dorashkat e duarve apo litheset e kepuceve. Eshte nje mot i acarte, ku papritur gjaku mund te mpikset ne damare e nje gjume i embel mund te te pushtoje, duke te ndare nga jeta.

Keto tabllo te siperfaqeve te akullta ketu ne kryqezimin e rrugeve te qytetit te ri e te vjeter te Bulqizes me ate qe te percjell drejt Shupenzes nuk i shpetojne kameramanit te televizionit lokal te kesaj zone. Edhe ai leviz ate per te kapur keto grimca jete te paperseritsme te pikturuar nga kjo stine dimri sa e bukur e emozionuese aq edhe vuajtjesh e peripecishe per studentet e nxenes qe duan te parqiten ne auditoret e klasat e migranteve qe te arrine ne frontin e punes ne Angli, France, Germani, Greqi, Itali etj.

Nuk pame as edhe nje shenje te skorieve gjate ketije udhetimi dritherues e te frikshem, ndersa per kripen apo magazinat e makinat e posaçme per ti hedhur ato pergjate tyre as qe mund te perfytyrohet. Sakaq nje fugon rreshqiti poshte rruges, degjuam klithma njerizish, te cilene frika u kishte hyre ne palce. Fatmiresisht ai nuk u permbys. E lidhem me kavo, e me stermundime e ngjitem ne rruge. Ndodhemi ne fshatin Vajkal.

Kalojme mbi uren e Topojanit, poshte saje gurgullon i qete por i turbullt ujet e Drinit. Nga energia e renies se lire mbi turbinat e Hidrocentraleve te Fierzes. Komanit e Vaut te dejes na ndriçohen shtepite, pallatet shumekateshe rruget e bulevardet e qyteteve. E urojme pikerisht ketu :sa me shume bore e shi, aq me shume drite, duke harruar ate qe ne pame nepermjet xhamave pak ore me pare pse jo edhe tani. Syte na perplasen ne nje cope mure me nje forme te çrregullt. Nuk e di nese koha apo njerzit, ketije i kane shuar domethenien e tije. Njerzit dhe koha binom historie . Ato ndryshojne, transformohen ne vazhdimesi.

Etimologjia e kesaj fjale eshte e lidhur me heroizmin qe ka ngulur rrenje ne ndergjegjen e ketyre banoreve ne kushte gjeografiko historike te veçanta. Topat jane, me thjeshte vendi ku jane vedosur kjo arme; topa- jane. Ja nje grimce e ketije heroizmi. Beteja e pergjakshme kunder ushtrise se serbise . ne Dhjetor njemije e nendeqinde e dymmbedhjete ne Qafe te Topojanit, ne fshatin me te njejtin emer, e te ura. Gjylet e topave te artilerise se armikut derdheshin si pikat e shiut . E megjithate armiku la ne fushen e betejes tridhjete te vrare nder ta tre ishin oficere. Te deshtuarit u kthyen mbrapsht, por jo pergjithmone. Ky ishte nje grimce ne gjerdanin e episodeve te panumurta .

Por kjo lugine, kjo rruge, ka qene vend pusishe, gjekemarrjesh siç eshte vrasja ne pabesi e trimit Muhurrake, Gip Pira nga Sali Kaja vegla e verber ne duar te Hasan Bej Karasanit. Nuk eshte momenti te hapim dosjen e ketyre tragjedive te tmerrshme.

Realitete kohe e njerezish

Nderkaq rruga gjarperon permes nje relievi te thyer, krejtesisht te bardhesuar. Nga kodrat e Llasenit na shfaqet befasisht Debrova, nje lagje me nje histori te lashte . Emri i saj lidhet me fisin ilir te Penesteve, Debrei. Ndersa shohim njerez qe levizin duke shkelur boren, e krijuar rrugica qe lidh pallatin, dyqanin, hotelin. Nuk behet fjale per pune ne ndertim, ku edhe ketu nuk mungokan kantieret. Kjo stine me te ftohtin e ngricat i ka paralizuar keto.

Ne dalje nga kjo lagje shfaqet nje ndertese e bardhe me dy minare e cila sundon me bukuri e madheshti tabllon kodrinore te ndertesave te tjera te qytqetit te Peshkopise. Krenohemi me kete kult fetar qe na e dhuruan Arabet, kuptohet, investimin ne leke e projektin. Ndersa saper ndertim ne dibranet jemi mjeshtra te perkryer.

Edhe Romaket me vone Bizantinet ngriten shume kisha ne keto ane. Nder ta shquhej ajo e Shen Shqefit qe ka qene qender e peshkopatit nga ku rrjedh edhe emri i sotem i qytetit.

Sapo kalojme uren e prroit te Llixhave. shoqerohemi nga ndertesa ne te dy anet, ku te gjitha jane dyqane, punishte te ndryshme. Dhe te shkrep ne tru nje mendim, nje ide, nje pyetje. Amund ta nxjerrin buken e gojes gjithe keto tregetare?Jo me pak se shtatembedhjete vjete keto numeroheshin me gishta te se njejtes dore, dhe vetem ne krahun e siperm. E pergjigja vjen vetevetiu :sigurisht qe po. Sa kane ndryshuar marrdheniet ekonomiko shoqerore, njekohesisht mjedisi dhe njerezit!

Mrekullia e bulevardit kryesor eshte mahnites, blijte me kurorat gri te hapura e aty ketu bora siper tyre me gumzhitjen e banoreve te cilene ne keto momente nuk iu ka mbetur gje tjete veçse te shijojne me endje e dashuri feminore keto. Bleme nje gazete te nje djalosh i imet ne fytyre, i veshur keq i cili iu sherben me gjentilese bleresve, pi kerisht ketu ka qene Biblioteca e qytetit, ku sherbente me kompetence e pasion Ulvi Shehu e pak me tej li brashitsia Bukurie Alku. Ku jane? Hapsirat e muruara tashme i kane ‘‘pushtuar,, mallrat te markave te ndryshme, maqedonase, italiane, angleze kineze etj, etj.

Ne ish lulishten e pallatit te kultures, nje ndertese modene prej xhami. Eshte kompleksi i lokaleve te Pajtim Gjures. Edhe kjo ka ndjekur ne ndertimin e saj legjenden e Kalase se Shkodres. Muret e se ciles ndetoheshin diten e shembeshin naten. Por edhe kjo e sfidoi kohen, politiken, ligjin shtetin,, ndodhine e legjendes.

Duket si i vetmuar i braktisur nga njerezit e koha busti i Heroit Gjok Doçi, perreth tije nje lulishte e shkaterruar e lokale ku pushohet e pihet nje gote raki apo kafe. Me tej nje banor i ri i derdhur ne nje bust modest, poshte nje shqiponje me dy krere. eshte Halil Alia. Jeta e tije eshte mjafte

komplekse e shoqeruara me drite hije te shumta. Komplekse e plote labirinthe si vete historia e Shqiperise dhe e Dibres ne veçanti.

Ashtu vetevetiu me vjen ne mend deshprimi nga politika e atyre koheve te Legjendarit Elez Isufi pas plagosjes nga plumbat e ushtareve serbe pati thene '' Ne mos vdeksha kesaj rradhe, do te kap shkopin dhe do te ruaj dhite e Slloves., , Por ai mbylli syte duke lene pas epope heroike ne altarin e historise

Borë në verë e dimër

Udhetojme drejt Muhurit, kodres se Kubenit nuk i mungon velloja e bukur e bores. Por me terheqese e romantike do ta kishin bere pishat me kurorat te ngarkuara me bore, fatkeqesisht kete peisazh mud te na e rikujtoje ndonje piktore apo fotografe, sepse ato jane zhdukur ne vite nenetdhjet, nenetedhjete e dy nga njerz me sopata e motoshrra. E ç'na duheshin keto!Ne vitet njemije e nenteqinde e dyzete i kishin mbjelle ushtria italiane.

Veshtrimi me rreshqet lehtazi ne vargmalet hijerende te Runjave, aty çaje permes grykes se Setes e ndalem te maja e Kurores se Lures. Keto kreshta kane veshur rroben e bardhe e pikerisht ketu qendron poesia e momentit e cila me rizgjon kujtesen. Ishte fund Tetori 1921 kur Elez Isufi shkruan nje leter deputetit Kristo Dako ''…Nga mungesa e munizionit, te armeve e te topave . . Ushtaret jane te zhveshur e te zbathun. pa kapota, pa kepuce, pa çadra, pa valenza, pa çorape, pa spata, pa kazma e pa lopata…''Me ane te grykave te pushkeve e te mitralozeve, me trimeri luanesh e sakrifica te panumurta po shkruhesh fundi i barbarizmave serbe. Ne keto momente jemi ne vigjilje te betejes se pergjakshme te Lane Lures

Kujtesa me shpalos nje dukuri te çuditshme. Disa dite, pa dashur te s'madhojme per pak jave ne fund Korrikun e vitit dymije e shtate ne Dibren e poshtme ka rene bore. Si ndodhi, mund te pyesni me kureshtje adoleshenti. Shume thjeshte. Me pakujdesite apo me miredashje, qe nga pyjet me dushqe te fshatit Hotesh, shpatet e Molles, te Prates. pishnajat e Balgjajve . te vargmalit te Runjes, te Kurores se Lures. Kishin marre flake. Vatrat e tyre ne nete e nxehta e te shkurtera te ketije muaji ndrisnin nga ghuhet e zjarrta. Tymi kishte krijuar nje mbulese si mjergulla qe krijijon natyra ne dimer. E hiri krijonnte shtresa te dukshme mbi gjelbrimin e mbetur, mbi çattite e mbi makinat e pse edhe ne floket e e njerezve Nuk eshte fantazi as e Zhyl Vernit e as e shkrimtarit Alqi Kristos. Ishte ver me nje dielli pervelues e pa as nje pike shi, e ndersa njerazit e shteti ishin te pafuqishem per te kufizuar apo asgjesuar keto vatra zjarri shkatrrimtare per pyjet e natyrenne pergjithesi. Pamja e ketyre maleve qe Albonologu shquar Gjerman Hahn njeqind e dyzete e kater vjete me pare i kishte quajtur Malet eZeza , tashme kishin veshur rroben e zeze te zise . me e erret me deshpruese e me tmerruese per te gjithe asamblin e gjallesave

Duke veshtrar ne televizor e me hapet nje sipar tjeter : Bilbil e Mimosa Ferati vriten ne Bathore te Tiranes per gjakemarrje nga Hajdar Puci nga Luznia. Familjet jane mbyllur brenda. Policia i ruan ato. Kronika te tilla nuk jane te pakta ne gjithe masmedian shqipetare. Kodi gjenetik i primitivitetit te ketije zakoni ende thur rrjeten e merimanges se dhimbjes, mjerimit, gjakut qe derdhet bashke me rinine qe fiket si flaka e kandilit. Ende se ka zgjidhur as besimi te perendia, as te hoxha e prifti, as te shteti e ligjet. Tragjedi makbethiane e pafund.

Lufta e pashpallur e aksidenteve rrugore eshte e permasave alarmante. Per tre dite vdesin tete veta e plagosen shtatembedhjete. Gjaku i pafajshem shkruan dramen me te pegjakshme te udhetareve per gabime nga me te pa perfytrueshme . Nje bote e tere vuan nga kjo mynxyre . Shifrat edhe per kete rast jane kokeforte, tetee mije persona vdesin ne Itali e me marramendese shifra prej nje milion ne mbare rruzullin. Lufte e pashpallur, shprehen sociologet por me terre te pafundme.

Paralizë energjish, Sytë e emigrimit

Leme pas Kodren e Shen Diellit, i afrohemi ures se Drinit. Shterngojme duart e perqafomi me ish drejtorin e Mermerit te Muhurrit inxhinierin mekanik Skender Leken.

Biseda rrjedh natyrshem, per rinine muhurake qe derdh energjite fizike e mendore duke punuar qe nga Shtetet e Bashkuara te Amerikes, Anglia, Greqia Italia etj. Duke lene pas vendelindjen mjedise te heshtura, pa gjalleri e gezime rinore. Parku i plepave ketu buze Murres nuk gumezhine me. Ndersa peisazhi i shemtuar e shkatrimeve te ish klubeve e lokaleve te injekton hidherim e deshprim, ketu nen pyllin e plepave qe kane humbur gjethet por kane fituar bardhesine joshese te bores. Shpati i malit te Molles ku shtriheshin punimet e Minieres se Mermerit te shembellen me nje peisazh pellazgjik, te rrenuar. Deshprimi, dhimbja, pesimizmi, largimet ne emigrim edhe sot i te rinje qe sapo mbushin te gjashtembedhjetat. Vendet e punes, ndermarrjet, punishtet ku te prodhohet diçka, mungojne krejtesisht e per rrjedhoje nuk mungojne edhe shpernguljet masive drej bregdeti e shteteve prenditmore. Te gjitha keto dukuri perbejne mozaikun social-ekonomik qe karakterizon shoqerine e buze drinasve.

Kujton Skenderi me nostalgji feminore viziten qe ai kishte bere ne fund vititin njemije e nendeqinde e nentedhejete e dy ne minierat e mermerit ne Masa Karrara te Italise qendrore. Prodhimi i te cilit ka filluar ne thellesi te shekujve, ne epoken e Romakeve. Televisioni e gazetat e ketije vendi ishin te pushtuara nga aventurat e rinise emigrante shqipetare. vjedhjet, grabitjet, perdhunimet, fallsifikimet, pamjet e barakave e perndjekjet qe u benin policia etj. Per keto kishim spostuar Marokenet duke dale ne vend te pare.

Koleget kerkonin te dinin per burimin e te gjitha ketyre, aventurave banditeske. Perpiqesha tiu shpejgoja arsyet, social ekonomike, psikologjike, duke i krahasuar edhe me flukset e emigrimit te tyre pas luftes se dyte boterore drejt Shteteve te Bashkuara te Amerikes, Kanadase Australise, e bemat e tyre atje, si edhe mos njohjen e historise shume te vjeter e te re te shqiperise.

Nderkaq, po udhetojme permes Maqellares. Mantela e bardhe e bores nuk u mungon as shtepive te reja e te vjetera, pemeve e gardheve e peisazhit kodrinor te ketyre vendeve. Nje levizje e çrregult e enjerezve te shumte ne te dy anet e rruges. Eshte dite e zakonshme. Nuk eshte per tu habitur . Keta njerez nuk kane pune. Ata jetojne me te ardhurat e emigrimit. Syte e mendjea iu fluturojne ne shtete te ndryshme te botes. Nje veprimtari njerezore ne paralize, energji te derdhura per te tjeret. Sa e dhimbshme aq edhe tragjike per nje popull per nje komb. Natyrshem lind pyetja: Por sa do te vazhdoje kjo plage e stermadhe djerse gjaku mundimehsh?

Peizazhe, histori

Kisha dhjete vjete qe nuk kisha ardhur ne airoportin e Rinasit ketu ne Tirane. U befasova . Perpara me shpaloset papritur nje konstruksion metalki, parku i makinave, sallat e kontrollit e kullae saj, nje lulishte me strukture forme e bimesi zbukuruese e mahnitshme. Me peshtillen ne shpirtin e zemren time emozione te thella. Papritur pyes veten :Ku nndodhem?Sigrisht ketu, ndonje shtet modern me teklologji te kohes kishte vene dore . Me plote shije estetike e kulture professionale. . Nje kompani Germane. . Edhe sherbimi. e veshja e nepunseve, punonjesve, sjellja plote kulture e policeve ishte per tu admiruar e patur zili.

Kaluam ne kontrollin individual. Nje vaze me floke te zeza e trupe e holle si nje atlete me thote :Hiqni edhe kepucet. . Kjo ishte surpriza. Menjeher pyeta veten: tani do te hyje ne xhami. Pse jo tetedhjete e dy perqind e shqipetareve jane muslimane. Nuk me kishte ndodhur ne asnje airoporte te vendeve te tjera te perendimit. Çudite ndodhin ketu ne vendin e shqipetareve. E si, jane norma sigurie, sepse edhe para e pas meje verejta te njejten dukuri.

Avioni fillon ngjitje. Nderkohe ne kishim vene rrypat e sigurimit e degjonim me vemendje keshillimet e stiuardeses ne rast rreziku. Pime kafete e nga dritaria me konturohe peisazhe te ndryshme. Kodrat me dushkaja te Ishmit. Fshatra me shtepi te vendusura sipas shijeve, mundesive e deshirave, Rruge te pa asfaltuara e makina qe me duken si mizat e dheut. Me tej fusha te kuadratura me shtepia si kutia shkrepse, te vetmuara, si ne nje fushe shahu, kur dy lojtaret jane ne mes te gares. Te papunuara te zymta pa gjallerese, e si te shkretuara. Eshte peisazh dimri. A po diçka tjeter. Enigma do te shtjellohet me tej.

Buze deti me plazhet e pafund te reres, e ujet e tije diku futet me shume ne toke duke i dhene nje perthyrje ngjyres blu me ngjyren e reres. Sa kaq hyme ne nje mjergull. Udhetonim drejt lartesise dhjete mije metra. Ne krahun e avionit nje drite fiket e dizet vazhdimisht si nje xixellonje ne pranvere.

Papritur nje pamje magjepse me ndez emocionet . Eshte nje hapsire e pafund me kodra, kodrine, te cilave ndonjeren dielli mengjezor e lepine me rrezezt e tij. Duke i dhene nje ndriçim te praruar. Kam mbeshtetur koken te xhami i dritares se avionit e me konturohen lugina, kurrize te thepisura, livadhe te formave te ndryshme. diku edhe kreshta malesh si ato te Bjeshkeve te Namura apo te Korabit. Emocinet e ketyra peisazheve gri te hapur me perthyerjet e drite hijet e tyra me kane pushtuar çdo qelize te trupit. Germoj ne kujtes per te rizgjuar memorien, e sa kaq pena merr udhe.

A nuk ngjajne keto peisazhe me nje bukuri te mrekullueshme me ato te Pllaut? Pse jo. Ato valezimet, gropat tektonike gjigande . lendinat ku jeshilon bari e lulet shumengjyrshe. Ne pranveren e hershme lulet zonje porfumojne. era e lehte ne kete hapsire nga malet e Lukanit e gjer ne shkrepat e Gure Lures

Ne keto mjedise ne vere gumzhine nga tufat e deleve, kopete e dhive e te lopeve, nga kostare, qe kosisin barin . Eshte ky ushqimi i dimerimit te tyre. Eshte kjo ejta e ketyre malesoreve te çidhnes, Arrasit, Sinjave. Bulaçit, shqathit e Muhurrit e ndertuar mbi njemije nje sakrefica, me djerse, lodhje e mundime te pafundme. Per te çuar perpara jeten gjallesen e tyre, te familjeve shpesh numer shumte.

Ne keto mjedise ku ne dimer mbreteron bora. Vargmali i Runjes, sherben si nje ballkon gjigand, nga i cili mund te shohish si ne pellembe te dores peisazhin bukuridhurues mahnites e joshes te Dibrave. Historia edhe ketu ka shkruajtur faqe te tera heroizmi te dhimbshme. . Ne keto vende kane kaluar mijera refugjate Dibrane, ne dhjetevjeçarin e luftrave te pergjakshme kunder satanikeve serbe. . Te rraskapitur, te sbathur, te leckosur. me nje torbe me pak buke thate, me femine ne gji. Udhetonin pleqte, burrat te pamundeshmit per lufte, grate e femija dibrane ne kollone me nete e dite te tera, ketyre honeve e pyjeve drejt Shkalles se Desheve te Macukullit, per te gjetur nje strehe jete e mbrojtje nga shkiau mizore e i pabese

Gazeta ''Dielli ''e njezete e gjashte Tetorit e dymbedhjete nentorit te vitit njemije e nendeqind e njezete e dy shkruante''. . Shume prej vendaseve mbeti neper male…me shume se dyzetemije zbriten gjer tatpjete ne fushen e Tiranes, dhe gjeten strofken ne Kavaje, Kronia(Kruje), Shijak dhe Elbasan;por sot ato nuk kane mbetur me shume se dhjete mije, meqe te tjeret humben nga semundjet dhe mungimet., , Sa debitore i kane mbetur ketyre luftrave, episodeve makabre, ngarjeve te dhimbshme e dramave te emigrimit pena e poetit, shkrimtarit, dramaturgut skenarit te filmave e historianeve Dibrane.

Ndersa vete populli i frymezuar nga moment i ka kenduar ne thellesi, shpirti e zemra, e jane trasmetuar, e konservuar me fanatizem ne memorien e tije. Eshte derdhur edhe ketu gjak, per nje kos bare, per nje cope livadh, apo per dikush qe ka dashur te zgjeroje kufijte. Ka qene Haxhi Pashe Sakati (Zogolli), ne luften per te marre Pllaun e humbi ne saje te trimerise se Nezir Lleshit, i cili i sprovuar ne luftrat kunder hordhive turke me Ali Pashe Tepelenen doli fitimtare. Ne rrjeshtat e rapsodise kushtuar kesaj ngjarje gjejme edhe emrat e Nuz Metes, Lik Rines, Ali Lales, Selman Loshit te cilet u shquan per trimeri e heroizem te pashoq.

Duke belbezuar vargjet plote muzikalitet te kesaj kenge, papritur mu shkeput filli i saje nga nje pamje krejtesisht tjeter, e zeri i stuardesese:Jemi prane airoportit te Pizes. . eme pas ajo dha parametrat e klimes.

Nje bregdet ku pas plazhit me rere dukesh nje brez i stergjatur pishnajash. Fshatra me shtepi te vendosura ne rrjeshta ku ne mes kalonin rruge e nje gjelbrim me drure e shkurre perher gjelberta. Apo vila me pishina te rrethuara me te gjelberten joshese, e nje arkitekture me perthyerje e shije estrvagante . Toka te kuadratuara e te jeshiluara nga gruri. Rruge automobilistike te asfaltuara, te vizuara me vija te bardha e anash tyre drure te madhesive e llojeve te ndryshme.

Ne keto tabllo sa terheqese aq edhe melankolike, eshte kondensuar ne gurgullimen e shekujve diturite, mjeshterite, kultura, organizimi i shtetit qe nga etrusket, latinet, romaket, e toskanasit e sotem. Eshte produkt i gjeneratave te tera qe me mund, djerse, sakrefica te panumurta, e inteligjence, te krijojne pamje e bukuri te tilla joshese, emocionuese e frymezuese.

* * *

Ne hapsiren e realitetit qe preceptohet, e ate te imagjinates e kujteses ''notuam,, me penen per te dhene, te gjalle,, ne levizje e ndryshim te vazhdueshem udhetimin tone.

I mveshen atije me kujdese diçka romantike, poetike, ngjizem epiken me heroiken . ne qender te kesaj onde centrifugale, Njeriu, shoqeria me komplekset e saja.

Firence 28. 1. 2008

Literatura:
Hazis Ndreu, "Dibra ne udhen e historise", Tirane, 2003
Bajram Xhafa, "Lufta e dibres 1920", Shkoder, 2001
J. Gordad "L'Albanais en 1921". Paris, 1922
Luniversale. La grande eciclopedia Tematica Milano 2005
Fatos Medi Daci "Enciklopedia e Dibrës" (vol I), Tirane, 2006
J. G. v. Hahn, "Udhetim neper viset e Drinit e Vardarit" (perkthim), Tirane, 2001
Rakip Sinani, "Dibra dhe dibranet ne faqet e historise", Tirane, 2005

MA DALLGËZOVE SHPIRTIN VELO CFARKU

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Më mirë mos ma kishe dërguar atë libër Velo Cfarku, mos ma merrje shpirtin e ta dallgëzoje atyre maleve, atyre vendeve që hyjnë e mbeten përjetë si një ëndërr, asaj treve ku ti linde e unë mora e mbusha shpirtin me një tufë kujtimesh që syrgjyni (dhe vetëm ai) i ve në qendër të jetës. Se ty, i dashur Velo, nuk të ra shorti i jetës të syrgjynosesh, të udhëtosh në legjendën "Nëntë male kaptuar", të përballesh me gjuhë tjetër e dhunën për t'iu përshtatur vendit të huaj. Ti Velo ishe e Velo mbete. E vetmja rrugë e jetës tënde ishte nga malet e Gollobordës; nga Gjinoveci, Klenja e Trebishti në Peshkopi. Më pas shkove në Lezhë e siç më tha Kozmai tani ke ngreh një pallat në Tiranë.

Unë, megjithëse "Nëntë male kaptuar", më ndodh, kur takoj apo flas me ndonjë dibran, të iki (si ai qengji i Naimit) me mend atyre vendeve e të bujë në ato kulla apo kasolle mbi male. Unë, vazhdoj të jem dibran jo vetëm shpirtërisht, por edhe ligjërisht. Ende nuk e kam hequr (dhe nuk do ta heq) qenien qytetar i Peshkopisë, megjithëse bashkë me fëmijët, e kam një shtëpi në Tiranë dhe nja pesëqind metro katrorë tokë në Kamzë. E shumta që mund të bëj është që ta spostoj gjendjen civile në Zdojan, në fshatin ku linda dhe ku kam varret e prindërve. Por këtë do ta bëj kur atje, në majë të asaj kodrës që sheh tërë luginën e Drinit të Zi e Nëntë malet e Dibrës, të bëj një kasolle dhe të dremis vitet e fundit të jetës...

Kur Kozma Traja më dha letrën tënde të ngrohtë (Ti nuk mund ta kuptosh se sa të ngrohta janë letrat e vendit tënd, veçanërisht kur vijnë dhe mes kujtimesh të marrin me vete) dhe librin tënd të parë, "Golloborda në optikën e kohës" dallgët e shpirtit i kaluan tetë ballët. Diçka kam shkruar si meditim të atij takimi, diçka që ndonjë ditë do ta lexosh.

Ç'është e vërteta unë gjatë këtyre viteve jo vetëm një herë kam qenë në Gollobordë.

Jo fizikisht, por me shpirt e me zemër, në udhëtime fantastike. Kam qenë në Ostrenin e Madh me vëllezërit Rama. Kam qenë edhe në Ostrenin e Vogël me Eduard Sulën, dibranin që i shpëtoi dhunës detare të anijes Sibila të marsit të egër 1997, duke lënë mes dallgëve të zeza djalin, gruan dhe vëllanë. Kam qenë edhe në Tuçep e Lladamericë, në ato kopshtet e bukura ku rriten pemë gjithfarë llojesh, ku ka një burim, një kanal ujitës që kalon kufirin, një hidrocentral. Kam qenë edhe në Pasinkë e Tërbaç. Madje Tërbaçin e kam lakuar në sa e sa shkrime falë një miku që kam nga Tërbaçi i Vlorës. E din ti, i dashur Velo, se Tërbaçi i Vlorës e ka konakun dhe gjakun e të parëve të vet nga Tërbaçi i Dibrës? Unë e kam parë të shkruar me germa të mëdha (shprehje krenarie labe) në muzeun e fshatit, muzeun "Hysni Kapo" siç e quanin atëherë. E trazuar është Shqipëria, i dashur Velo, e trazuar. Jemi një edhe pse historia (dhe histeria e fuqiplotëve) na kanë dashtë të ndarë e të përçarë. Aq të ndarë sa është i vetmi vend në botë që është prerë, siç pritet berri për kurrizi e qendrën gjeografike të vetën (francezët kanë Verdunin) e ka jashtë kufijve, diku midis Dibrës së Madhe dhe Strugës. Ti je mësues i shkencave ekzakte dhe mund të bësh matje, matje të cilat të jesh i sigurt se nuk luajnë "me pash".

Me thënë të drejtën, i dashur Velo, e kisha dëshirën që ta bëja një rrugë mes përmes Gollobordës. E ëndërrova dhe e planifikova dhjetëra herë vitin e kaluar kur një miku im emigrant më tha se kur do të përurojë lokalin e tij në Librazhd do më marrë me vete. E pata skicuar që, pasi të kaloja natën në Librazhd, të nesërmen t'i zija pritë ndonjë furgoni që udhëton drejt Gollobordës. Më kishte marrë malli të mbushja grushtat me ujë në ato çezmat në shkallën e Lunikut, të hidhja një sy mbi ato kullat e gurta të Llangës, kulla ku mjeshtëria e të ndërtuarit ka bërë monument, e të ndalesha për pak minuta në fushën e Studnës, atje ku një herë e një kohë patatet formonin kalldrëm mbi tokë e kamionët autokolonë transporti. Doja, kur të ngjitesha lartësive të Steblevës, bjeshkëve të mrekullueshme të Kallkanit të mblidhja një dorë lule mali e me një vështrim t'i përcillja larg në malet e Okshtunit e Prodanit, atje ku Haki Stërmilli i madh i letrave dibrane pat shkruar ditarin e tij të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqiptarëve.

E kam me vete Haki Stërmillin. E kam jo me veprën e botuar, por me të pabotuarën, me "Dibra në prag të historisë". Diçka shkruan Hakiu edhe për Gollobordën e fillim shekullit të kaluar. Diçka kam edhe unë në një bllok me shënime të nxjerra nga gazeta " Përlindja e Shqipërisë ", botim i Qeverisë së Vlorës në vitet 1913 – 1914. Po e lë në qetësi pak kompjuterin në kërkim të tyre...

...Të dytën harroje. Në bllok kam vetëm këtë shënim: "Përlindja e Shqipërisë", vjeti II nr, 4, 11/24, kallnduer 1914, e shtunë.

Flet për barbaritë serbe në Gollobordë nën titullin "Udhëtim në Gollobordë", vazhdon edhe në nr. 5, 15/28 kallnduer 1914...

Më vjen keq që nuk e kam. E kisha vendosur atëherë që ta fotokopjoja të tërë shkrimin që thuhej se ishte bërë sipas tregimit të një diplomati. Nuk u bë sepse atëherë (1988) fotokopjuesi i Bibliotekës Kombëtare ishte tepër i ngarkuar.

Mund ta kopjoni ju, i dashur Velo. Jeni në Tiranë dhe kohë keni me bollëk. Unë po të kisha këtë privilegj do të mbillesha e mbija në bibliotekë.

Të parën, atë që e dokumenton Haki Stërmilli në "Dibra në prag të historisë" mund të ta shkruaj pa i bërë ndonjë "redaktim" në gjuhën drejtshkrimore të sotme...

"...Zoti Kenedy, misionar Amerikan në Korçë, me përpjekjet e mundimshme që hoqi për Kombin Shqiptar, u bë i shtrenjtë për ne. Shkon n'atë kohë edhe në Gollobordë për tu ba disa ndihma atyre ma nevojtarëve. Shoqi i tij shqiptar, mbasi përshkruan bukuritë natyrore të Gollobordës, ban në formë përshkrimi edhe psimet e këtyre katundeve në kohën e okupimit serb:

Në Fushë Studën shofim nji vorr dhe pranë vorrit nji shtëpi. I vrami qe i zoti i shtëpisë së djegun. Përqark kanë pa edhe shumë shtëpi të djegura ndonëse Studna në atë kohë kishte qenë brenda kufinit tonë. Ma përpjetë bje në Zabzun dhe ka ndalë vetëm në dy shtëpi se të tjerat ishin ba gërmadhë e hi. Njena prej kësaj shtëpie kish ba fli dy vëllazën. Ke xhamia tregon nji grue faqe së cilës i vranë të shoqin, Halil Aganë. Prej këtij trishtimi gruaja hikën dhe len foshnjën pranë shtëpisë. Serbët kur dogjën shtëpinë e kapën edhe djalin e vogël dhe e hudhnë në zjarr të gjallë...

...Më tutje shohim nji vorr dhe në gërmadhë të shtëpisë së djegun gjejmë të mbeturat e grues, e cila kishte qenë djegun ma parë në zjarr...

...Në Zabzun u vranë 34 vetë dhe u dogjën 175 shtëpi..."

Me dhimbje, i dashur Velo, me dhimbje jemi ngjitur në të përpjetën e historisë për të bërë vend midis kombeve të Evropës, të asaj Evrope që nuk na deshi, që na ndau e na përçau, të atyre fqinjëve që copa lakmonin të merrnin duke na konsumuar kafshatë pas kafshate derisa një ditë të dilnin në Durrës, Shëngjin e Vlorë, duke na brejtur tërë kockat.

Fatmirësisht qëndruam. Ndoshta edhe në sajë të zgjuarsisë dhe fjalëve të asaj gruas që përmendet në historinë e Trebishtit, të asaj gruas që foli shqip, kur shqiptarët dhe shqipen (edhe sllavishten) duhej ta kërkonin tutje Tetovës e Gostivarit, në Shkup, Preshevë e Nish, në Ulqin, Tivar e Vermosh...

Më ngope me ajrin e pastër të atyre maleve, i dashur Velo, në udhëtimin tënd të fundit në Klenjë e Gjinovec me zotin Zibitko. Do të doja të isha edhe unë me ju, veçse, pasi të pija një kafe në qytezën e sharrëtarëve të më jepnit leje të zbrisja pak në Steblevë për tu dalë përpara sipër, tek ai dyqani me artikuj të përzierë anës rrugës. Kisha dëshirë ta shoqëroja në raki atë plakun e vjetër të Avdëve, Ibrahimin, atë që na mori përkrahu nga sharra e na çoi në shtëpinë e tij, që u deh e na vuri në kor të këndojmë (edhe ne çakërrqejf) refrenin e asaj këngës së tij të çuditshme, këngë me dy vargje "Më ka humbë një dhi, kërkoj një cjap". Në mos gaboj (pleqëria bën të vetën) kemi qenë bashkë atë natë. Kaq humor e shpirt mikpritjeje nuk kam gjetur gjëkund në udhëtimet e mija maleve të Dibrës.

Ke një farë dallgëzimi në shpirt, i dashur Velo, kur në Klenjë e Gjinovec kërkon të kaluarën, kërkon Budinin e ujit të pijshëm e të ujëmbledhësit të Golemovës, kërkon "shatërvanët" e ujitjes së fushës. E pashë që të erdhi keq që nuk u ngjite në Raduç, nuk ece midis barit dhe luleve të atij mali të lartë që është bukuri e bukurive të zonës. Thoshe se u frikësove nga retë në qiell kur duhet të thoshe se frikësoheshe nga "retë në kokë", ato lloj resh që të zbardhin kokën e të ndalin këmbën në të përpjeta. Ma ka ënda të udhëtoj edhe një herë atyre maleve, por nuk më len këmba. Ma ka ënda që t'i bije mes për mes Klenjës, të ndalem pak tek spitali e të marr të përpjetën në perëndim, atë të përpjetë që të çon në një majë, ku pamja e Sebishtit me lumin mespërmes, me gjelbërimin dhe shtëpitë pranë e pranë të tërheq si me magnet.

Ma zbehe pak dëshirën e një udhëtimi nëpër ato vende të bukura kur shkruan se atje tashmë mungojnë shkollat, spitalet, njerëzit. Golloborda në syrin e kohës qenka tjetërsuar. Bukuria e vendit pa bukurinë e njeriut pranë e pranë, pa punën e tij u zbekërka aq shumë sa ti, duke kërkuar qoshkat e kujtesës tënde të fëmijërisë e rinisë, humbe midis degësh e ferrash...

Nuk e harrova Trebishtin, i dashur Velo, të Tre Bishtat që e formojnë atë; Bala, Muçinë e Çelebi. Nuk kisha si ta harroja, sepse atje kam qenë disa herë dhe në një ndër tubimet e tij me rastin e 70 vjetorit të hapjes së shkollës së parë shqipe, paralele në kohë me atë të Peshkopisë, më 14 prill të vitit 1914 (në mos më ka lënë kujtesa për datën) kam mbajtur edhe një kumtesë. Tema lidhej me disa aspekte të psikologjisë së punës të ndërtuesit gollobordas. E pata punuar me dashuri atë kumtim. Me dashuri dhe ovacione u prit nga njerëzit e ngjeshur si sardelet në kuti në sallën e shtëpisë së kulturës. Me shënimet tuaja, veçanërisht me fotografitë, më ktheve një çerek shekulli pas. I kam ato fotografi, në letër dhe në negativ, se edhe unë, si puna jote, jam paksa manjak në ruajtjen e gjërave. Kam një arkiv të tërë me fotografi e me negativa që nuk di se çfarë ta bëj dhe si ta administroj. Atë kohë, dhe ata njerëz, edhe pse kanë qenë heronj të mëdhenj ndërtimesh, që kanë ngritur qytete, fabrika, hidrocentrale e kanale ujitës i shohin me sy vëngër dhe (kur janë gjallë) u japin një pension sa as për bukë thatë e kafe nuk mjafton.

Asokohe, bashkë, i qemë ngjitur kodrës përpjetë, rrugës për në Gjinovec dhe më tej në Klenjë. I mban mend ato tubat që shtriheshin gjatë gjithë rrugës për t'i dhënë Trebishtit ujë? Jam larg se do të rrëmoja në fotografi e në filma dhe me siguri do të gjeja ndonjë pamje të Tre Bishtave nga lart dhe të kanaleve e tubave në montim.

Më vjen keq që Klenjës ia kanë marrë "pushtetin", por nga ana tjetër më vjen mirë që ai ka bërë vend në Trebisht, fshat që nuk është i madh vetëm për numrin e shtëpive e të banorëve, por është i madh për numrin e njerëzve që ka nxjerrë e kanë bërë vend në historinë e Shqipërisë si ndërtues, mjekë, historianë, mësues, ushtarakë e të tjerë. Nuk po i përmend me emra, sepse i ke prezantuar ti më së miri në shënimet e tua. Megjithëse, midis tyre do të veçoja mikun tim, mjekun dhe njeriun Arif Hasani, që shtëpinë e tij në Trebisht e ka kthyer në një spital modest ku edhe mund të bëjë operacione të urgjencës. Po ashtu desha t'i bëj një homazh nderi dhe respekti edhe historianit të njohur Hilmi Sadiku, kontributi i të cilit në nxjerrrjen në pah të vlerave historike të Dibrës, për mua, është i nivelit për t'u shpallur "Qytetar Nderi i Dibrës".

Në letrën tuaj, miku im Velo, më shkruaje, duke më dërguar "si dhuratë simbolike librin tim të parë "Golloborda në optikën e kohës" se "Ju jeni gazetar, sigurisht, do të keni dhe vlerësimet tuaja". Më ngjan, se duke udhëtuar me ty faqeve të librit, në ato vende me bukuri natyrore dhe njerëzore, me një histori të lavdishme pune dhe qëndresë atdhetare, e kam thënë fjalën time në atë masë sa do ta kisha për nder të isha bir i asaj treve.

Megjithatë e kam një rezervë, rezervë që përvoja e dymbëdhjetë viteve në emigracion, vite aktive edhe në fushën e publicistikës, më ka ngacmuar dhe më ngacmon, më bën të tund kokën mendueshëm. Këtu miku im, për interesa të mbijetesës, një numër jo fort i vogël shqiptarësh, kanë ndërruar fenë dhe kombësinë, kanë ndërruar emër e vendlindje. Janë bërë "vorioepirotë" edhe pse janë prej Dibre, Kukësi, Tropoje, janë bërë "ortodoksë" dhe "vaftisen (lexo kungohen) edhe pse të parët e tyre kanë qenë muhamedanë, edhe pse ata u rritën në një klimë ateiste dhe nuk njohin asnjë lloj riti fetar... Të tjerë e kanë shpallur veten "çobanë", "arumunë grekë", duke marrë dokumente e leje qëndrimi për kohë të gjatë, duke aplikuar për nënshtetësi greke dhe duke dërguar fëmijët e tyre me bursa në Rumani kur nuk dinë asnjë fjalë rumanisht. Një miku im dhe i juaji (nuk po ia përmend emrin) për t'i shpëtuar ndjekjeve kur ende nuk ishim legalizuar e prezantonte veten si serb, duke përdorur si "pasaportë" sllavishten e vendlindjes së tij. Këtë njeri, para një viti e takova në Tiranë. Duke pirë kafe para galerisë së artit, duke qeshur më vuri përpara pasaportën e tij bullgare, pasaportë e cila me futjen e Bullgarisë në Bashkimin Evropian, i hapte atij rrugët e gjëra të Evropës...

Kur i mendoj të gjitha këto, duke shtuar edhe ato që lexoj e dëgjoj në Shqipëri për "romë", "egjiptianë", "malazezë", "maqedonas", "arumunë", "bullgarë" etj., etj., më krijohet përshtypja se në Shqipëri nuk ka shqiptarë, se shqiptarët janë minoritet, janë mysafirë në truallin e tyre të lashtë, truall i cili me mbretër parakristianë si Pirro i Epirit, Aleksandri i Madh i Maqedonisë e më vonë mbretëresha Teuta, mbreti Genti, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu etj., përbëjnë rrënjë të forta të një gjeneze të lashtë.

Në replikat tuaja përdorni shpesh e më shpesh fjalën "Maqedoni" dhe "maqedonisht". Shoqërisht dua t'ju them se jeni futur në një thekër që nuk ka fund, që hyn dhe nuk del dot.

Maqedonia si vend, shtet madje edhe Perandori, i përket periudhës para Krishtit, kohës së Filipit dhe Aleksandrit të Madh të Maqedonisë. Fara e banorëve të sotëm të trevës së hershme të Maqedonisë është hedhur, ka bërë rrënjë dhe ka lidhë fryte në shekullin e gjashtë – shtatë pas Krishtit. Në librat shkollorë të Maqedonisë, siç dëshmonte në një emision televiziv Ali Ahmeti i BDI – së, thuhet se të parët e tyre kanë ardhur në shekullin e 6 – të. Në historiografinë greke, shqiptare dhe nga historianë të njohur evropianë thuhet se banorët e para shekullit të 6 – të në atë hapësirë gjeografike ishin ilirë dhe grekë. Nuk po hyj më thellë, le ta thonë fjalën historianët e jo gazetarët për hollësi, por ama një fakt tepër të njohur dua ta them, faktin e pushtimeve dhe të shpërnguljeve (dhe të gjenocidit) të indianëve të Amerikës nga

(Vijon në faqen 11)

PO VJEN SHKENCËTARI HILMI KOLGJEGJA

Nga **XHAFER MARTINI**

Kur mësova që Hilmi Kolgjegja vuante nga një sëmundje e rëndë, vendosa ta shikoj, por hë sot hë nesër, veç kur mora vesh që ai kishte ndërruar jetë. E mora vesh nga goja e njerëzve, sepse mjetet e informimit nuk thanë asnjë fjalë për humbjen e tij? Ato duhej të thonin, pasi Hilmiu nuk qe një njeri i zakonshëm. Ai i dha shumë kulturës sonë. Është vërtet turp të mos përbëjë lajm vdekja e një njeriu si Hilmi Kolgjegja, në një kohë kur shumë njerëzve, me vlera shumë më të pakta, u kushtohen emisione të veçanta.

Libri i Hilmi Kolgjegjës "Folklor nga Dibra"(1990), me 750 faqe, botim i Institutit të Folklorit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është padyshim përmbledhja më e madhe dhe më e rëndësishme e folklorit të mbledhur ndonjëherë në rrethin e Dibrës. Ajo u përmbahet kritereve shkencore dhe është një kontribut shumë i madh, pothuaj shterrues, përsa i përket folklorit të Dibrës. Natyrisht, vështruar nga arritjet dhe horizonti i të sotmes, libri në fjalë ka edhe të meta dhe dobësi, sidomos në shpërpjesëtimin e lëndës, që mishërohet në një zmadhim tej mase të folklorit të ri në krahasim me atë të së kaluarës së hershme; ky shpërpjesëtim duket edhe në raportet midis poezisë dhe prozës, ku proza zë një vend shumë të vogël. Përveç shpërpjesëtimeve, ka edhe ndonjë krijim që nuk do ta meritonte të ishte në këtë vëllim, pasi nuk është tamam krijim i popullit dhe kjo dëshmohet, para së gjithash, me nivelin e dobët artistik. Nga kjo vuajnë mjaft krijime poetike të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Nganjëherë nuk është respektuar deri në fund dialekti i trevës ku është vjelë materiali. Vetëm një shembull për ta ilustruar. Në përrallën "Hisen Selmani", mbledhur në Sohodoll, ka edhe një fjali të tillë: *"Na q`të mihajr, shqere në gisht ene, kur të kalojsh para saj, qite dorën si ta shofi kralica, se ajo di vet si ban".* Siç është lehtësisht e kuptueshme, folja shqere, me kuptimin shtie, fute, përdoret në Lurë dhe jo në Sohodoll. Nganjëherë burimet e lëndës janë të diskutueshme, pasi mbledhësi nuk i drejtohet direkt popullit, por personave gjysmë të shkolluar, që bëhen rrezik kulturor kur identifikohen me popullin, pasi krijimet e tyre pa cilësi i paraqesin si krijime të popullit.

Por, gjithsesi, këto janë të meta të vogla, që nuk e ulin në tërësi vlerën e madhe të vëllimit "Folklor nga Dibra", që do të jetë përherë burim referimi dhe objekt studimi për brezat e ardhshëm. Interes të madh shkencor paraqet strukturimi i lëndës së mbledhur. Siç është e natyrshme, fillohet me epikën, me këngët legjendare, ku renditen tetë prej tyre, disa fort të rralla dhe shumë të bukura, si: *Sula i vogël ka ra borgj*, *Iseni i Vogël, Krajsi pushka bregut t`Drinit* etj. Epika historike është më e plota. Në të janë përfshirë rreth gjashtëdhjetë këngë. Autori ka meritë se, midis disa varianteve, ka zgjedhur variantin më të mirë, ku plotësohen dy kritere kryesore: lashtësia dhe niveli artistik.

Këngët e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit socialist zënë një pjesë të madhe të vëllimit. Jo pse është bërë zakon që të kritikohet dhe të ulet gjithçka e kësaj periudhe, por duhet thënë se ky kapitull është më i dobëti për nga niveli artistik dhe mjaft prej këtyre krijimeve janë të ideologjizuara. Kuptohet se ideologjizimi e sjell me vete në mënyrë të pashmangshme mediokritetin. Po Hilmiu nuk ka ndonjë faj për këtë. Lirika zë një vend shumë të gjerë në librin "Folklor nga Dibra". Këtu ka këngë vërtet perla, ku dallohen lirikat e mërgimit ekonomik, të mërgimit ushtarak dhe, veçanërisht, këngët e dasmës, të paraqitura sipas riteve. Por kryeperlat janë këngët e dashurisë, ku ka vërtet mrekullira:

"Kam di molla nër jelek
Nër jelek i kam di molla
Mora njanën e kërkova
Idht si mjalti e zi si bora"

"Moj e majra n`at` kojshi
Luej zelifet e ban me si,
Do t'çoj lala di rixhaxhi.
- Rixhaxhitë nuk i due
Do marr xhigimat do shkoj n'krue.
Kur t'pisë nana: pse je vonue?
Shkreçi i krojt turbullue
N'skaj t'shamisë e kam kullue…"

Këto dy vargjet e fundit janë nga ato perla që do t'i kishin zili poetët më të mëdhenj të globit. Por le të vazhdojmë më tej:

"Moj e mira, ku t`ka rritë nana,
M'i ke vetullat si gajtana,
M'i ke sytë si dy filxhana,
Ftyra jote ndrit si hana,
Përmbi brez ke dy molla
T'idht si mjalfti, zi si bora…"

Dëshira për të cituar është e madhe, por këtu nuk është vendi. Ai që do të shijojë artin e popullit dibran, librin e Hilmi Kolgjegjës "Foklor nga Dibra" duhet ta mbajë në tryezë të punës.

Një libër i dorës së parë është edhe "Perlat shqiptare" (1999), ku, veç disa kërkimeve me karakter mbarëshqiptar, (që nuk sjellin kushedi çfarë), ka një pasuri të madhe të kulturës popullore të Dibrës, si: tregime të shkurtra historike, kuriozitete nga lashtësia, shprehje frazeologjike, tregime alegorike, pyetje proverbore e kanunore, gojëdhëna, shpjegime ëndrrash, fjalë të urta, këngë satirike dhe rrëfenja në vargje, pyetje e përgjigje, humor, fabula, këshilla, etj. Libri jo vetëm është i këndshëm në të lexuar, por edhe me vlera të qenësishme artistike. Edhe në këtë libër, ashtu si në gjithë krijimtarinë e Hilmi Kolgjegjës, bije në sy dashuria dhe nderimi i tij për kulturën e popullit, përpjekja serioze jo vetëm për ta mbledhur krijimtarinë e tij, por edhe për ta paraqitur sa më mirë nga ana gjuhësore dhe strukturore.

Një krijim folklorik, sa është në popull, latohet dhe përsoset, kalon gojë në gojë dhe ndryshon në formë, madje edhe në përmbajtje sipas situatave bisedimore dhe qëllimit të rrëfimtarit. Këto lloj krijimesh janë vazhdimisht në zhvillim. Kjo është në gjë shumë e mirë, por ekziston edhe rreziku i humbjes së tyre me vdekjen e bartësve më të talentuar. Kur i mbledh dhe i shkruan dikush, ky rreziku i fundit mënjanohet, por krijimi tashmë ngrin, me atë formë gjuhësore që i jep mbledhësi. Prandaj mbledhja e folklorit, paraqitja shkrimore e tij ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe është një detyrë që mund ta kryejnë si duhet vetëm ata që kanë kulturën e nevojshme dhe nderimin e madh për krijimtarinë popullore.

Haki Stërmilli ka mbledhur dhe botuar tek "Fyelli i Dibrës"(1944) mjaft prozë popullore, që e ka paraqitur me besnikëri, ashtu si ka dalë nga goja e popullit, pa zbukurime dhe tjetërsime, pa ia hequr autenticitetin dhe ngjyrimin emocional që ka përçuar populli. Mbledhja e Stërmillit nuk bëhet më së dyti, atyre përrallave nuk guxon kush t`u japë një veshje tjetër, veç asaj që kanë.

Hilmi Kolgjegja në vëllimin "Perla shqiptare" në mjaft krijime ka treguar po atë ekzigjencë shkencore që ka treguar edhe Stërmilli.

Po japim vetëm pak nga perlat e shumta:

* * *

"Humoristi Kolë Tivari nga Shkodra ka qenë rrobaqepës. Njëri shkoi tek Kola me qepë një kostum. Megjithëse kishte pak stof, i tha:

- Të lutem, or Kolë, bane si ta bash e qitma edhe nji jelek.

- Po, mor ta marrsha, por nuk del stofi, - ia ktheu Kola.

- Ban çfarë të duesh, veç pa jelek mos më le,- iu lut klienti.

Kola nuk i ktheu përgjigje dhe me kaq u ndanë. Pas dy javësh erdhi klienti dhe i tha:

- Hë, Kolë, e qepe kostumin?

- Gati e ke, veç vishe ta provosh.

Ai veshi kostumin dhe iu drejtua Kolës:

- Kostumi më rrika për merak, por jeleku ku asht?

- Shihe se e ke në xhepin e prapmë të pantallonave, - ia ktheu Kola.

Klienti futi dorën dhe nxori një jelek katër gishtërinj të gjatë".

***

Dibrani pyeti korçarin:

- A ka mbajtë dimër i madh andej nga ju?

- Kaq ftohtë po bën, - ia ktheu korçari, - sa pështyma bëhet copë akulli pa ra në tokë.

- Ndërsa në Dibër ka bërë kaq ftohtë, sa një mace, duke kërcyer nga një çati në tjetrën, ngriu dhe mbeti në ajër.

- Kjo është e pabesueshme, - tha korçari, - sepse, sipas ligjit të Njutonit, macja duhet të kishte rënë patjetër në tokë.

- Mirëpo ishte aq ftohtë, saqë edhe ligji i Njutonit kishte ngrirë, - ia ktheu dibrani".

* * *

Njëri nga Kavaja e pyeti shokun e tij gjirokastrit:

- A bën shumë vapë andej nga ju?

- E ç'e pyet!? - iu përgjigj gjirokastriti. - Te ne, po ta lësh brumin përjashta, piqet e bëhet bukë.

- S'qenka kushedi çfarë të nxehti, - ia ktheu kavajasi. - Te ne, po të mos u japësh pulave akullore në darkë, i bëjnë vezët e ziera".

* * *

Përgjegjësia e mbledhësit është e madhe, se folklorit, për qëllime të ndryshme, i drejtohen studiuesit, shkrimtarët, filozofët, muzikantët, gjuhëtarët, mitologët etj., etj. E theksojmë një gjë të tillë, sepse shikojmë të botohen plot libra më lloj-lloj rrëfenjash, tregimesh, alegorish etj., por nuk kupton se për ç'qëllim këta autorë i janë drejtuar krijimtarisë së popullit. Në qoftë se i janë drejtuar si mbledhës, pse "mbledhin" gjëra që janë mbledhur një herë? Por, për drejtimet tjera u mungojnë "kryqet", si thotë populli, prandaj as vetë nuk dinë çfarë bëjnë.

Lexuesit e "Rrugës së Arbërit", në tre numra të kësaj gazete, duhet ta kenë vërejtur mënyrën dhe qëllimin për të cilin i është drejtuar shkrimtari Agron Tufa traditës së popullit tek studimi mjaft interesant *Semiotika e dasmës shqiptare* (në variantin e Dibrës).

Hilmi Kolgjegjia iu drejtua folklorit si mbledhës dhe këtë e realizoi shkëlqyeshëm.

* * *

Lëvizja e lirë e njerëzve bëri që shumë intelektualë ta linin Dibrën dhe të vinin në Tiranë. Kështu bëri edhe Hilmiu. Për shumë intelektualë, shkëputja nga "tabani" bëri që ta ndienin veten si peshku në të thatë; ata nuk e kishin më rrethin shoqëror e miqësor, as punën që kishin kryer; u vunë në kërkim të një identiteti të ri, që të mos e ndienin veten si ato zogjtë që i rrëmben tufani. U përpoqën të krijojnë shoqata, të botojnë libra etj. Dhe mirë bënë e bëjnë. Por "plaka, - thotë populli, - nuk mund të bëhet nuse", në kuptimin që janë disa punë që duhen filluar qysh në rini dhe duan përkushtim të madh e talent për të vjelë "ndonjë frut" prej tyre aty nga fundi i jetës, nëse ajo është e gjatë. Me Hilmiun nuk ndodhi kështu; ai edhe në metropolin e kulturës e ndjeu veten "në të njëjtat llogore". Ai nuk luftonte për një identitet të ri, se e kishte krijuar atë me kohë. Ai gjatë këtyre viteve punoi për të përgatitur librin "Perlat shqiptare" si dhe botoi disa numra të revistës "Lura", një revistë e bukur, që nisi për së mbari të pasqyronte në faqet e saj kulturën e trevës së Lurës, bukuritë e saj mahnitëse. Këtë punë Hilmiu e bëri me sakrifica të mëdha, sepse ata që kishin para nuk ishin kurdoherë të gatshëm t`i jepnin ato për kulturën e trevës së tyre, që nuk ishte vetëm e tyre, por e mbarë kombit. Për të kuptuar në çfarë vështirësish financiare dhe morale ishte Hilmi Kolgjegja, mjafton të jap këtu një ndodhi, që ma ka treguar një gazetar dibran:

"Isha duke ndenjur me disa biznesmenë në një lokal, - nisi ai.- Pas ca kohe pamë Hilmiun që po vinte drejt nesh. Gjithë preokupimi i tij i madh ishte që ta mbante revistën "Lura", dhe për këtë ishte i detyruar t`u kërkonte para biznesmenëve. Ata i kishin dhënë para për nja dy numra, por revista duhej të kishte vijimësi. Në vend që ky njeri të ndihmohej dhe të inkurajohej, pritej dhe përcillej me mungesë respekti, nganjëherë edhe fyhej si ndodhi atë rast, kur njëri nga biznesmenët tha: "Po vjen lypësi!" Mua më erdhi rëndë, por, duke qenë pak a shumë në rolin e Hilmiut, nuk guxova t`i ktheja përgjigjen që meritonte."

- T'i kishe thënë: "Nuk po vjen lypësi, por shkencëtari Hilmi Kolgjegja", - i thashë unë.

- E drejtë, kështu duhet t'i kisha thënë. Më ka mbetur peng që nuk thashë pak a shumë kështu, se Hilmiu meritonte çdo respekt.

Dikush mund të buzëqeshë me ironi, pse po e quaj Hilmiun shkencëtar. Po le të mos nxitohemi… Duke mos kontestuar shumë doktorë dhe profesorë, që i kanë dhënë mjaft shkencës dhe kulturës në fushat përkatëse, duhet thënë se ka edhe prej atyre që këto grada i kanë marrë me çerekun e punës së Hilmiut. Si mund ta quash ndryshe Hilmi Kolgjegjën që ka botuar rreth një mijë faqe nga visaret e kombit dhe një mijë faqe i ka lënë në dorëshkrim? Dhe kjo nuk ishte puna me të cilën ai merrte rrogën. Dhe ky nuk ishte kontributi i tij i vetëm. Përveçse mbledhës folklori, ai ishte krijues i teksteve të këngëve që i kompozonte vetë, me një muzikë shumë të pëlqyeshme, ku zinin vend motivet popullore, të "thyera" dhe të pasuruara nga talenti dhe zemra e tij e ndjeshme; ishte instrumentist, shkrimtar, valltar, koreograf, dirigjent, udhëheqës artistik. Ai shumë vite u ka mësuar muzikë nxënësve dhe ka përgatitur grupe artistike. Por, kur flasim për Hilmiun si shkencëtar, këtu kemi parasysh punën e tij të jashtëzakonshme për mbledhjen e folklorit. Hilmiu nuk ishte shkencëtar kabineti; ai ishte shkencëtar i terrenit, i maleve dhe i fushave, i fshatrave dhe i qyteteve; ai gjatë dyzet vjetëve ka përshkuar në këmbë, në zheg të vapës dhe në akull e dëborë, qindra kilometra në kërkim të fjalës së bukur shqipe, duke e mbledhur atë si bleta nektarin nëpër lule. Nuk shëtiste me dieta shteti, por me paret dhe djersën e vet, me atë rrogë të vogël që merrte. Nuk e detyronte askush, veç pasionit që i vlonte në zemër, veç dashurisë për gjuhën dhe kulturën shqiptare. Hilmiu hynte në çdo vatër, mblidhte visaret e popullit dhe, kur shkonte në shtëpinë e tij të vogël dhe gati të pabanueshme, strukturonte materialin e mbledhur.

Dhe kjo punë ishte e përditshme, e përjavshme, e përmuajshme… 40 vjeçare… E pra, si mos ta quaj Hlimi Kolgjegjën shkencëtar?!

U bënë disa vjet që Hilmi Kolgjegja na mungon. Nuk e kemi më midis nesh për t'ia parë buzëqeshjen e çiltër, për t'ia dëgjuar zërin dhe, mbi të gjitha, për t'ia shijuar bisedën e ngrohtë dhe miqësore që vetëm ai dinte ta ndërtonte në atë mënyrë, duke komunikuar mirë me të gjithë.

Kështu, një nga një, kush para e kush pak më mbrapa, të gjithë do të ikim. Ikën fizikisht njeriu, por kujtimi dhe vepra e tij nuk vdesin. Nëse nuk besojmë që shpirti jeton edhe pasi njeriu vdes, duhet të besojmë që shpirti "i materializuar" në krijimtari është vërtet i pavdekshëm.

1) Tufa, Agron.Semiotika e dasmës shqiptare(në variantin e Dibrës)."Rruga e Arbërit", nëntor – dhjetor, Tiranë 2007.

Haxhi Skënderi (Ademi), një emër i njohur në arsimin shqiptar

Përpjekjet dhe lufta për shkollimin e mësuesit Haxhi Skënderi përkojnë në një nga periudhat më të trazuara të historisë tonë kombëtare, të luftës ballkanike, të luftës së parë dhe të dytë botërore. Haxhi Skënderi (Ademi) u konfirmua si mësues i kompletuar e bashkëpunues me mësues të tjerë të krahinës si Syrja Spahiu, Faslli Cani, Haki Pahumi Gafur, Kara Ibrahimi, Hidër Manjani, Mustafa Shahinaj, Mehmet Çadri etj.

Haxhiu u lind në vitin 1890 në fshatin Gjoricë e Epërme. Fëmijëria e tij kaloi përmes vuajtjeve e sakrificave të mëdha e aq më tepër që dhe prindërit i vdiqën kur ishte ende fëmijë. Që në moshë të vogël u detyrua të përballonte jetesën e vështirë të atyre viteve. Djaloshi që po rritej jetim ra shpejt në sy të pleqve të fshatit për zgjuarsinë si dhe mjaft cilësi të tjera që për moshën që kishte këto ishin virtyte të rralla. Kështu, vetë fshati e dërgoi Haxhiun në një shkollë jetimore të Dibrës. Këtu, përveç mësimit, ai përvetësoi edhe disa gjuhë të huaja si turqisht, italisht dhe frëngjisht. Në këtë sfond politik historik, trazirash e konfliktesh të ushtrive pushtuese për interesa të ndryshme, Haxhiu u detyrua të emigrojë në fillim në Francë e më vonë në Itali. Aty, krahas punës, vazhdoi dhe shkollën. Në vitet kur atdheu ishte nën regjimin e Zogut Haxhiu kthehet në Shqipëri, tashmë jo fëmijë si dikur, por i rrahur nga dallgët e vështira të jetës. Edhe pse kishte përfunduar një shkollë të mesme në perëndim, Haxhiu filloi dhe shkollën normale të Elbasanit, të cilën e mbaroi me rezultate të larta. Pas mbarimit të kësaj shkolle në fillim u caktua mësues në Kastriot, pastaj në Arras. Me kërkesën e tij u transferua në fshatin e lindjes Gjoricë. Këtu nuk kishte shkollë, por me vullnet dhe përkushtim dhe në bashkëpunim të vazhdueshëm të pleqve të fshatit arriti të ngrejë godinën e shkollës së parë shqipe në Gjoricë.

Kështu, më 2 shtator të vitit 1925, direkt nën kujdesjen e Haxhi Skënderit, u hap shkolla e parë shqipe në fshatin Gjoricë, ku vinin edhe nxënës nga fshatrat Bllacë, Lubalesh, Çerenec, Viçisht, Tërbaç etj. Si

mësues i përgatitur dhe i përkushtuar në fushën e pedagogjisë si dhe për marrëdhënie të mira mësues–nxënës, Haxhiu ka lënë mbresa të pashlyera tek ish nxënësit e tij. Dhe këto mbresa i kanë shprehur herë pas here. Me respekt sot shprehet ish nxënësi i tij Xhetan Tasha:

"Haxhi Skënderi (Ademi) ka hapur shkollën shqipe në Gjoricë të Epërme. Unë kam vazhduar shkollën në vitet 1938-1946. Janë me dhjetëra nxënës të tij që kanë mbaruar shkollën me rezultate të larta e shumë prej tyre janë bërë dhe kuadro të aftë. Haxhiu shkonte vetë shtëpi më shtëpi për të sjellë fëmijët në shkollë. Në katër klasa kolektive jepte mësim vetë mësuesi Haxhi Skënderi. Mjaft nga ish nxënësit e tij mbushën radhët partizane dhe rrokën pushkën kundër pushtuesit, pasi vetë Haxhiu ishte një patriot. Puna e mësues Haxhi Skënderit nuk mjaftonte vetëm në shkollë. Një punë të madhe edukative bënte dhe në fshat me pleqtë, por dhe me ata të rinj që hezitonin të frekuentonin shkollën. Ne na edukonte vazhdimisht me frymën e luftës kundër veseve të këqija, si dhe ruajtjen e traditave të mira të kombit tonë".

TË NDEROSH FIGURËN E MËSUESIT

Vlerësimi i figurës së mësuesit Haxhi Skënderi është bërë nga vetë populli dhe ish nxënësit e tij, të cilin e kujtojnë me respekt. Kaq nuk mjafton për një figurë të tillë të arsimit tonë. Është në nderin e Gjoricës që e lindi dhe e rriti, por dhe nderin e gjithë Dibrës që punoi me përkushtim, në qoftë se nderohet Haxhi Skënderi me titullin e lartë "Mësues i Popullit". Ky nderim besoi se i takon dhe nuk bëhet ndonjë privilegj. Haxhi Skënderi ka shërbyer si mësues dhe në mjaft zona të tjera të Gollobordës, si në Ostren të Madh. Ja si shprehet ish nxënësja e tij Kadife Muça:

"Mësues Haxhiu për ne nxënësit nuk ishte vetëm mësues, por dhe prind. Edhe pse punonte shumë në shkollën e Ostrenit të Madh para dite dhe pas dite, ai gjente kohë edhe për të argëtuar nxënësit e tij".

Në Gjoricë ka shërbyer si mësuese edhe Drita Zhulali. Ja si shprehet ajo: "Kam punuar në shkollën e Gjoricës në vitin shkollor 1949-1951 bashkë me burrin tim Shemsi Zhulali. Afër nesh ndodhej dhe shkolla e Gjoricës së Epërme, ku ishte mësues Haxhi Skënderi. Ai ishte një mësues me përvojë të gjatë pune në fushën e mësimdhënies dhe ne mësuesit e rinj përfituam shumë nga mësues Haxhiu. Shpeshherë, në mbledhjet që bënim ne, na mësonte se si të veprojmë në ato kushte të vështira që ishte shkolla në ato vite. Të gjithë fshatarët e Gjoricës flisnin qysh atëherë fjalët më të mira për mësues Haxhiun. Unë bashkë me burrin tim kam pasur fatin që të shkoj dhe në familjen e tij. Aty jam habitur për mikpritjen që na bëri, por më shumë u habitëm me rregullin dhe harmoninë që ekzistonte në atë familje".

E kush nuk e kujton sot Haxhi Skënderin në Gjoricë, por dhe jashtë saj. Ai kujtohet me dashuri dhe respekt nga të gjithë se respektin ua impononte të tjerëve. Haxhi Skënderi ka shkrirë të gjithë energjitë e tij në çështjen e arsimit shqiptar, sidomos në ato vite të vështira që kalonte vendi ynë. Haxhi Skënder vdiq në moshën 90 vjeçare duke lënë pas trashëgiminë shpirtërore për brezat e ardhshëm. Megjithatë, mendojmë se përjetësimi i kësaj figure të kulturës dhe arsimit kombëtar kurrsesi nuk duhet të mbetet në udhëkryq. Kjo figurë dhe të tjera si kjo e që Dibra ka mjaft, ia vlen të përjetësohen.

Nadire Skënderi (Murra)

ABONOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Abonimi vazhdon për periudhën **deri në Dhjetor 2008**
dhe kushton **50 lekë për numër.**
Abonimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: **Cel: 068 31 19 232** ose në numrat fiks **(04) 357 179; 233 283.**
Abonimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë **"Fleta XXI"**, pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. **tel: 0218 4233.** Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

Duke bërë abonimin tuaj, ju bëheni pjesë e gazetës!

Esat Ndreu, "Qytetar nderi" i Memaliajt

Më datë 15 mars në qytetin e vogël të Memaliajt, me vendim të këshillit bashkiak u shpall "Qytetar nderi" i këtij qyteti Esat Ndreu. Si një pinjoll i një familje me emër në Dibër dhe jashtë saj, Esati ishte një ndër komandantët legjendarë të Brigadës 18 Sulmuese. Ideali i tij kryesor ishte çlirimi i vendit nga pushtuesit e huaj. Pas çlirimit nuk do të shkonte larg shkëlqimi i këtij ushtaraku. Filloi shpejt për të dhe familjen e tij kalvari i gjatë i persekutimeve. Esat Ndreu bashkë me familjen internohet në qytetin e vogël të Memaliajt. Gjatë gjithë kohës që qëndroi në këtë qytet spikati inteligjenca, urtia dhe bujaria dibrane. E sot, me rastin e 98 vjetorit të lindjes, këshilli bashkiak i Memaliajt e shpalli Esat Ndreun "Qytetar nderi". Atë që duhej ta bënte Dibra që e lindi dhe e rriti e bëri Memaliaj, aty ku kaloi një pjesë të jetës së tij. Ky është një vlerësim i madh që i bën një qytet i vogël një figure të njohur të Dibrës.

DINE HOXHA, NJË MENDJE "KANDAR FLORIRI"

Nga **Prof.Dr.Myslim Islami**

Iniciativa e dy autorëve, zotërinjve Halil Rama dhe Shaqir Skarra, për të publikuar pas një hulumtimi të hollësishëm të jetës e veprës së Dine Hoxhës, siç e cilësojnë: "simbol i urtësisë dhe trimërisë", është një kontribut në historinë e krahinës së Dibrës e, për rrjedhojë, për historinë e Shqipërisë.

Edhe nga ana metodologjike autorët shënojnë një kontribut, sepse orientohen nga e veçanta për të arritur tek e përgjithshmja.

Dihet tanimë se në kohën e shtetit monist hartohej historiku i Dibrës e që andej dilnin apo plotësoheshin historikët e fshatrave apo të individëve.

Studimet historike, publicistike, pra, historia dokumentare ka vlerë, është edhe një bazë për studiuesit, poetët, gazetarët, skenaristët etj.

Duhet të shënojmë si një konceptim e trajtim të shëndoshë nga autorët që figurën e kanë ngritur në këtë monografi natyrshëm, me një frazë nga ana stilistike tepër korrekte e me një stil telegrafik.

Atdhetari Dine Hoxha, nga zotërinjtë Halil Rama e Shaqir Skarra na jepet për lexuesin si një personalitet popullor, me tru e zemër të madhe, një talent që i kish falur natyra një intuitë , mprehtësi e aftësi konkluduese të asaj shkalle që do ta kenë zili edhe diplomatë të arsimuar e politikanë, sepse ai burrë ish rrahur në dallgët e jetës dhe kish mbledhur si bleta mençurinë e popullit të vet.

Gjykimi dhe fjala e këtij burri nuk bie në tokë, sepse përfaqësonte mendimin e kohës.

Dine Hoxha, ky filozof e përfaqësues i mendimit popullor, që ndjell sikur të jetë një copë e shkëputur nga Korabi e që ruan të gjithë përbërjen e këtij mali kreshnik do të kujtohet me respekt e do të cilësohet si një shkollë për gjeneratat.

Fjalët e thjeshta, të gjetura e pa pompozitet e zbukurojnë logjikën e Dine Hoxhës, prandaj të ruhet gjuha e Dine Hoxhës, e Dibrës, fjalët, këshillat e gjykimet e tij, ashtu siç i ka thënë ai, të mos preken, të vihen në thonjëza, sepse ato përfaqësojnë burimin dhe koloritin e kohës dhe të zonës. Referencat të jepen të plota, arkivat, fondet, si dosje dhe si kohë.

Në këto lloj hulumtimesh të burrave të mençur, të trimave, të "odave", të "sofrave", të krahinave siç është Dibra, një korridor, një "port" në veçanti në kohën e perandorisë osmane si një urë lidhëse midis Perëndimit e Lindjes, midis trojeve të kombit shqiptar.

Kjo krahinë, siç del edhe nga ky botim, ka grumbulluar dhe regjistruar ngjarje e udhëheqës të mendimit e të luftërave dhe ka ditur të përjetësojë e t'ua përcjellë brezave.

Këtë mision patriotik kanë kryer të dy autorët dhe për këtë punë, lodhje e kujdes vlejnë të çmohen e t'u urojmë që vepra të tjera të priten nga këta autorë në të ardhmen.

Muhurri, vendlindja e Dine Hoxhës, cilësohet si djep i urtësisë së Nandë Maleve të Dibrës, aty ku derdhet Murra në Drinin e Zi, mbi kodër ishin ngritur kullat e të parëve të Dine Hoxhës. E lartëson jetën e mendimtarit Dine Hoxha fakti që nuk ra në pozitat e Esat Pashë Toptanit, por u lidh dhe u kuptua më së miri me Elez Isufin me shokë.

Trimëria e largpamësia e Dine Hoxhës kundër synimeve e veprimeve shovene të serbëve në vitet '20 të shek XX kanë zënë vend edhe në historinë e vendit.

Në çdo kohë Dibra ka nxjerrë njerëz të shquar, trima e punëtorë dhe kjo preket edhe në këtë botim.

Për "filozofë" e mendjendritur që fjala u peshon si guri e që njerëzit e dinë që nuk shkelin në dërrasë të kalbur edhe qeveritarë e mbretër kanë ditur t'i mbajnë afër dhe të konsultohen.

Ky burrë ka ditur t'u thotë "po" e "jo", se ishte trim dhe i mençur.

Kultivimi i sherbelës, një mundësi e mirë investimi

Nga **DALI HORESHKA**

Një nga problemet më të mprehta me të cilat po përballet sot ekonomia shqiptare është zhvillimi i integruarizonave rurale. Unë kam bindjen se një nga rrugët për të përmirësuar gjendjen ekonomike të familjes dhe pakësuar ndërhyrjen në pyje është kultivimi i sherbelës.

Sherbela (ose në latinisht Salvia officinalis) është një bimë me vlera kurative ushqimore dhe ekonomike.

Tregu i sherbelës: nga studime dhe vrojtime të shumta të tregut, rezulton se kërkesa për sherbelën rritet çdo vit me 25%. Shqipëria dhe Rajonet (edhe Dibra) janë të integruar në këtë treg. Po të bisedosh me tregtarët e bimëve mjekësore, të thonë se janë të gatshëm të firmosin kontrata mbi pesëvjeçare për prodhimin e sherbelës.

Leverdia ekonomike e një dynymi të mbjellë me sherbelë. Sherbela ka një rendiment prej 5-6 kv/dynym/vit. Tregtarët blejnë bucetën e sherbelës të tharë. Çmimi i një kg varion nga 90-110 lekë/kg. Por literatura tregon se nga sherbela mund të merret edhe mjaltë, në kuptimin e shërbimit si burim kullotje. Nga një dynym sherbelë mund të merren 30-60 kg mjaltë. Jo vetëm kaq. Ato që e nisin procesin të parët shumë mirë mund të përdorin degët e saj në pranverë si burim të ardhurash, duke ua shitur atyre që janë joshur nga kultivimi i saj. E njëjta gjë ndodh edhe me farën e sherbelës. Kësisoj, pa e tepruar, mund të them se nga një dynym sherbelë mund të merret jo më pak se 100.000 lekë të ardhura në vit.

Pra, kur një emigrant nuk merr më shumë se 3500-4000 euro në vit duke u endur nëpër arat e grekut dhe se një punëtor mund të menaxhojë një ha sipërfaqe prej 1 ha, a nuk është dy –tre herë më i fituar këtu në Shqipëri? A nuk mundet që me 150-200.000 lekë të blejë 10 koshere bletë?

Jo vetëm kaq, por unë mendoj se në Dibër është edhe më i fituar se në Durrës apo Tiranë. Çmimi i blerjes së fuqisë punëtore për një ditë pune nuk është më i lartë se 1000-1200 lekë në ditë, dhe i pasiguruar (në të zezë si i thonë fjalës) e më një lodhje fizike 2-3 herë më të madhe.

Me kultivimin mbrohet edhe bima, edhe pylli, edhe toka. Volumi i grumbullimit të sherbelës është ulur 3-4 herë në krahasim me vitet para '90. Duke e kultivuar atë jo vetëm që shtojmë të ardhurat, por shtojmë edhe vetë bimët, të cilat pavarësisht nga zbatimi i ligjit, në bazë të Konventës Ndërkombëtare mbi Mbrotjen e Natyrës, janë të ndaluara të shfrytëzohen.

Nga një dynym sherbelë mund të merret jo më pak se 100.000 lekë të ardhura në vit

Zonat e kultivimit: Zonat më të përmendura në rrethin e Dibrës për sherbelën natyrale janë Çidhën, Reç dhe Selishtë. Nuk ka dyshim se atje ajo është plotësisht e mundshme të kultivohet.

Zonat e mësipërme zakonisht e mbjellin tokën me grurë, misër dhe foragjere. Sikur rendimenti të jetë maksimal me këto kultura, duke e kthyer edhe qumështin në rendiment për dynymë, të ardhurat për dynymë janë të pakonsiderueshme: maksimalisht 5-6000 lekë/dynymi në vit. A nuk duhet provuar kultivimi i sherbelës, por dhe jo vetëm i sherbelës? Është momenti më i përshtateshëm për mbjelljet e këtij viti.

Kërkesat ndaj dritës: Ajo kërkon ndriçim (dmth diell), drejtim nga dielli.

Jetëgjatësia: ka një jetëgjatësi 5-6 vjeçare, çka do të thotë se është me prodhim të përvitshëm, por që kërkon investime vetëm një herë.

Kërkesat ndaj tokës: tokë të thatë dhe pa lagështirë.

Mënyra e shumëzimit të sherbelës: Ajo shumëzohet me farë, fidanë dhe copa. Sigurisht, që tani është momenti që ajo të mbillet me copa, duke i marrë ato nga bimët ekzistuese dhe me një kujdesje të mos prishet bima mëmë, duke i prerë me një thikë apo bisturi të mprehtë e të pastër. Kjo nuk do të thotë që tani nuk mbillet edhe më farë. Ekzistojnë shembuj të kultivimit të sherbelës në rrethin e Kukesit, nga ku në këto momente është për të mësuar nga ato. Ndër momentet më delikate për të cilat specialistët duhet të thonë fjalën e vet janë: momenti i prerjes së copave, mënyra dhe mjeti me të cilin priten copat, shtratifikimi i tyre në rërë (kështillohet për 3-4 javë) dhe momenti i mbjelljes në fushë (kështillohet temperatura 15-17 gradë) dhe mënyra e mbjelljes (në rrjeshta 50x35cm) duke i vendour bimët në vrimat e hapura me kunj (siç mbillen perimet) e ngjeshur me kujdes.

Kur mbillet me copa, një dynym kërkon 4000-6000 copë fidana. Ndërsa kur mbillet me fidanë, fidanishtja kërkon 20 m^2, me 10 gram farë/m^2 dhe 200 gram farë për një dynym, që është baraz me një vlerë prej 5000 lekë. Përgatitja e farishtes bëhet ose qysh në vjeshtë ose 6-8 javë para mbjeljes.

Shërbimet pas mbjelljes: Sherbela kërkon luftimin e barërave të këqija mekanikisht dhe një krasitje pas lulëzimit.

Momentet teknike të vjeljes dhe tharjes kanë qenë të zgjidhura, pasi përvoja ekziston prej vitesh me ato natyralet. Këtë kështillë shumë mirë mund ta japin tregtarët e bimëve medicinale.

Ndoshta "hyra në bahçe të tjetërkujt" me sa thashë më sipër, por shpresoj të mos kem gabuar. Edhe nëse po, ato që janë specialistë të mirëfilltë të kësaj fushe le të shkruajnë sa është momenti më i përshtatshëm apo le të nxjerrin libra që të lexohen.

Nuk është vetëm sherbela që ka një treg të garantuar dhe të ardhura të kënaqshme. Të afërta me të janë: trëndafili i egër (kaça), shtogu, çaji i malit, tërfili i egër etj. Është momenti qe t'i provojmë praktikisht rezultatet, duke formuar eksperiencat dhe më vonë për veprime të mëtejshme, deri tek grupet e bimëve të veçanta dhe "vula e një prodhimi të veçantë".

Nëse këtë vit do të marrin iniciativën rreth 50 fermerë të fillojnë kultivimin e bimëve mjekësore, duke kërkuar shpejt këshilla edhe nga profesorë të Universitetit Bujqësor, do të kemi më shumë të drejtë që t'i kërkojmë Ministrisë së Ambientit ta kthejë fytyrën nga mbështetja e kultivimit të bimëve mjekësore. Unë, sinqerisht, habitem se si ka mundësi që bimët mjekësore nuk janë të askujt: as të Ministrisë së Bujqesisë dhe as të Ministrisë së Ambientit, rrjedhimisht, as e Drejtorisë së Bujqësisë dhe as e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor. Unë besoj se u dhanë mjaft argumente për të thënë që pas perimeve, vendin e dytë për nga rëndësia e zënë bimët mjekësore dhe frutikultura. Bima mjekësore rritet edhe atje ku rriten frutat, por frutat nuk rriten

atje ku rriten bimët mjekësore. Atëherë, a nuk nuk duhet të kenë të njëjtën mbështetje edhe këto si frutikultura? Ndoshta, mbështetja financiare nga qeveria nuk është kaq e lehtë, por detyra për të mbështetur e financuar qendrat kërkimore eksperimentale me siguri që është e saj dhe urgjente.

Unë shfrytëzoj rastin të ftoj për të bërë shkrime gjatë këtyre ditëve të gjithë ato që kanë njohuri rreth sherbelës, shtogut, trëndafilit të egër, aguliçes apo edhe ndonjë bime tjetër. Edhe ato organizma që kanë interes në çështjet e zhvillimit rural, të rritjes së konkurueshmërisë së fermës apo inovacionit të bimëve bujqësore e pyjore, kanë vendin e tyre në këtë moment kritik të përgatitjes për mbjellje e vetëmbjelljes. Do të ishte një kontribut real në zhvillimin e zonave rurale.

Nga informacionet që kam, rreth 20 fermerë në rrethin e Dibrës kanë filluar përgatitjet për të provuar kultivimin e trëndafilit të egër, të sherbelës, të aguliçes, të shtogut. Edhe pse nëpërmjet gazetës dhe së largu, unë gjej rastin jo vetëm t'i përshëndes, por edhe t'i inkurajoj për këtë iniciativë që nuk do të jetë pa frut.

MA DALLGËZOVE SHPIRTIN VELO CFARKU

(Vijon nga faqja 8)

pushtimet e fuqive të mëdha evropiane të kohës, të shuarjes së gjuhës dhe të zakoneve të tyre dhe mbivendosjes së gjuhëve të pushtuesve.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, por edhe në Australi gjuhë zyrtare është gjuha angleze. Në Meksikë, Kubë, Kili, Argjentinë etj. flitet spanjisht. Në Brazil flitet portugalisht. Gjuha e pushtuesit është bërë gjuhë e vendit të pushtuar pa marrë emrin e vendit. Kështu askush nuk thotë se në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada flitet amerikanisht apo kanadisht, se në Brazil flitet brazilisht, se në Meksikë flitet meksikisht, se në Australi flitet australisht etj., etj. ndonëse gjuha bazë në këto vende; anglishtja, portugalishtja apo spanjishtja kanë pësuar ndryshime që mund të ballafaqohen me ndryshimet që ka pësuar sllavishtja në udhëtimet e saj nga stepat e Azisë në vendet e begata të Evropës e kryesisht të Ballkanit. Në këtë kuptim unë do t'ju sugjeroja që të bëni një "redaktim", të mos i jepni sllavishtes së mbivendosur në tokën e maqedonasve të Aleksandrit të Maqedonisë emërtimin "maqedonisht". Për të mos thënë edhe atë tjetrën që përbën aktualisht edhe precedent politik midis dy vendeve ballkanike (për të mos thënë tre) emrit Maqedoni, shtetit Republikë e Maqedonisë, republikë e cila mori emër si republikë e Jugosllavisë ashtu siç quhet në arenën ndërkombëtare edhe sot. Dhe ti e din mirë se si u krijua dhe kush e krijoi. E krijoi Titoja për të dobësuar serbët që kishin marrë në mënyrë arbitrare toka e popuj nga Konferenca e Londrës, e krijoi që t'i ndante dhe përçante shqiptarët në "tre republika" dhe në një krahinë autonome, Kosovën. Maqedonia si shtet i pavarur, si republikë, është shteti më i ri në Evropën e fundshekullit të njëzetë. Ndoshta jam i gabuar, por unë nuk kam lexuar gjëkundi dhe nuk kam dëgjuar për republikë maqedonase dhe shtet maqedonas në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, kësisoj edhe për gjuhë maqedonase. Në Dibër për gollobordasit ne kemi thënë gjithnjë që ata flasin bullgarçe... Ky është mendimi im edhe pse ju dhe çdokush tjetër mund të ma kundërshtojë.

Në letrën tuaj më shkruani se "Unë, tash së shpejti do të botoj një libër të dytë "Përplasjet në Dibër" me burim nga ndeshjet që kemi patur gjatë viteve në gazetë".

Për t'u bërë të mendoheni strem unë do t'ju përcjell një bisedë të bërë duke pirë kafe në turizmin e Matit në kohën kur isha korrespondent i ATSH – së, një bisedë me sekretarin e parë dhe kryetarin e rrethit...

...Ra fjala për Gani Tuçepin, ndërtuesin e madh të veprave ujore.

Ata ishin lidhë në telefon me Ganiun dhe i ishin lutur që t'i ndihmonte në projektimin e liqeneve artificialë të Balgjajt, liqene që unë i kam parë në vitin 1982 nga maja e malit që ndan Dibrën me Matin, madje edhe i kam fotografuar. I kishin thënë që do të dërgonin makinën që ta merrnin dhe së bashku të ngjiteshin në Balgjaj. Ai u kishte thënë se ai do t'i ngjitej në këmbë malit dhe takimin do ta bënin tek burimet që dilnin nga mali. E kishin kundërshtuar, por vendimi i Ganiut, kur ishte fjala për t'iu ngjitur maleve dhe për të piketuar kanale e ujëmbledhës, ishte i prerë. Ai donte që çdo gjë ta shkelte me këmbë.

Ishin takuar në lartësitë e malit, kishin parë vendin dhe kishin përcaktuar digat për liqenet. Nuk e kishin lënë të kthehej në këmbë. E kishin marrë me vete dhe i kishin shtruar një drekë në të ndarën e veçantë për mysafirë në turizmin e qytetit. Tek po drekonin të dy drejtuesit e rrethit, po bisedonin njëri me tjetrin për problemet e ditës, po gjykonin për gjëra që nuk ishin bërë mirë dhe se si duhej t'i kishin bërë. Ganiu, pasi i dëgjoi dhe i dëgjoi me vëmendje u tha: "Mos shikoni çfarë nuk keni bërë se sëmureni. Shiu që ikën nuk do tamar. Shihni përpara t'i bëni gjërat mirë, se ato të japin shëndet..."

Më ka ngelur në kujtesë ajo bisedë e tre dekadave më parë, mesazhi që u jepte një njeri i thjeshtë i punës, Ganiu nga Tuçepi i Dibrës, dy njerëzve që në vend ta mbanin kokën përpara e mbanin prapa.

Mos e boto atë libër, miku im. Nuk i vlen askujt. Dhe për më tepër nuk të vlen ty.

Përvoja e jetës sime në emigracion më ka mësuar se që Shqipëria të ecë përpara duhet që shqiptarët ta mbajnë kokën përpara. Ta mbash shikimin mbrapa, duke u dhënë këmbëve përpara, thyen qafën. Shqipëria dhe shqiptarët kanë nevojë sot të shohin vetëm përpara. Kanë nevojë për "qafë të fortë" që të tërheqë e vërë në brazdë parmendën e jetës...

Fola me ty sot, i dashur Velo, fola në një ditë të madhe për kombin e vuajtur shqiptar, fola më 17 shkurt 2008, në Ditën e Pavarësisë së Kosovës, në Ditën e Ëndrrës së Madhe Shqiptare, u përfshiva mes dallgësh gëzimi dhe krenarie që vetëm shpirti i lexon dhe i shkruan pa gabime...

Athinë, 17 shkurt 2008

“Merrini, ua solla profesor!”

Shtetasi Rruzhdi Bitri i dorë zon Institutit të Monumenteve, një përkrenare, dy eshtra dhe disa copa qeramike, të gjetura dy javë më parë gjatë punimeve në prej segmenteve në rikonstruksion të Rrugës së Arbrit

Si rrallë ndonjëherë, në ambientet e Institutit të Arkeologjisë, u zhvillua një ceremoni e pazakontë: ajo e dorëzimit të një përkrenareje e të disa gjetjeve të tjera arkeologjike, nga ana e një shtetasi kundrejt shtetit, në zbatim të ligjit mbi trashëgiminë. Por duke e ditur se sa pak të zbatueshme ligjet te ne e aq më pak të tilla ligje që zor se njeriut të thjeshtë i jepet rasti t‘i mësojë, akti i shtetasit Rruzhdi Bitri nga Dibra, ishte i formës apeluese për të gjithë ata njerëz, të cilët hasin gjetje të ngjashme, duke gërmuar tokën për shumë arsye e më pas, molepsen nga ideja se mund të përfitojnë miliona nga ajo që u ka rënë në dorë. Kështu për shembull ndodhi me kolegun e Bitrit, shtetasin nga Fieri, Florenc Hatija, i cili u largua natën nga vendfjetja në afërsi të frontit të punës, në një prej akseve në rikonstruksion të Rrugës së Arbrit në vendin e quajtur “Qafa e vorreve”, në rrethin e Bulqizës, duke udhëtuar me përkrenaren e gjetur drejt shtëpisë së tij. Ai jo vetëm nuk ia dorëzoi shtetit siç e kërkon ligji, por e fshehu atë, derisa shkoi policia e ia gjeti, ndodhur kjo katër ditë më parë. Ndërsa Rruzhdi Bitri, që në fillim tha se do ua dorëzonte autoriteteve përkatëse, siç edhe veproi. Me një ceremoni të thjeshtë, në prani të dy autoriteteve të larta të trashëgimisë siç janë drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës, Florenc Bejko, dhe drejtori i Institutit të Arkeologjisë, prof.dr. Myzafer Korkuti, Bitri nxori nga kutia përkrenaren e gjetur së bashku me disa qeramika, duke ua lënë në dorë përfaqësuesve më të lartë të institucioneve që merren me pasurinë kombëtare. Nga ana e tij, profesor Korkuti u shpreh me superlativa ndaj qytetarit Bitri për aktin e tij të dorëzimit të vlerave të gjetura, jo thjesht duke respektuar ligjin e trashëgimisë, por dhe duke u bërë shembull e model qytetarie e kulture për të gjithë individë të cilëve u ndodh e njëjta gjë. Pra që të gjejnë sende të vyera arkeologjike. “Është një rast i rrallë ky i sotmi që na entuziazmon. Është një ngjarje për ne”, tha Korkuti në çastet e marrjes në dorëzim të vlerave në fjalë.

Tashmë mbetet që në institut të kthehet dhe përkrenarja tjetër, ajo që gjendet në Fier e marrë në dorëzim nga policia. Pra, për raste të ngjashme, pati dy reagime: Nga njëra anë, vlera e gjetur rrëmbehet, fshihet e bëhet gati për t‘u trafikuar. Ndërsa nga ana tjetër, individi e dorëzon me vullnet vlerën e gjetur, duke thënë se ishte i kënaqur që i ishte dhënë shansi për t‘i kontribuuar në këtë mënyrë trashëgimisë dhe kulturës së vendit të tij.

Z. Rruzhdi Bitri duke i dorëzuar përkrenaren Drejtorit të Institutit të Arkeologjisë, prof.dr. Myzafer Korkutit

Faleminderit Ruzhdi Bitri!

Nga ARTAN LAME

Janë shumë të pakta shanset që një vdektar i zakonshëm të hyjë në faqet e gazetave pa qenë politikan a shtetar. Më e pakta gjë që duhet të bëjë, është të djegë ndonjë shtëpi, të vjedhë me maskë ndonjë autobus, të vrasë, përdhunojë, korruptojë, a të bëjë ndonjë tjatër gjë të ligë. Hapni të parën gazetë që ju del përpara, në cilën faqe t‘u zërë dora dhe do ta gjeni plot me të tillë emra, që nuk i kini dëgjuar kurrë, po që aty shkruhen me emër e mbiemër, se kanë bërë një prej trimërirave që rreshtova më sipër.

Dje në televizorë e gazeta u fol për një shqiptar të zakonshëm, Ruzhdi Bitri e thonë, që ju përmend emri pa vrarë e prerë njeri. Thjesht kishte gjetur një antikë, duke rrëmuar dhe e dorëzoi në muze. Pas njëzet vjetësh që vjedhim, djegim dhe nxjerrim nga themelitë muzetë, doli një që të bëjë të kundërtën. Pasi nuk lamë ikonë e libër pa shkulur nga vendi, pasi shitëm edhe helmetat kineze të kohës së Komandantit, vjen Ruzhdiu dhe çon në muze helmetën e kohës së Pirros e të Teutës.

Politikani që vë gurin e parë, që pret shiritin e rrugës apo që puth kalamaqër, e bën jo se ju doq barku, po se i duhet votat, ndërsa Ruzhdiu e bëri thjesht se i tha mendja dhe zemra. Këto gjërat e vogla të bërë nga vegjëlia, kanë më vlerë se gjërat e mëdha të të mëdhenjve, aq vlerë kanë sa më bëjnë të kthej mendje e të them se ka edhe shpresë të ndodhë çudia e të ndreqet ky vend.

Ma bëre mendjen lëmsh Ruzhdi, më prishe skemën që kisha në kokë, po s‘ka gjë, prapë të them faleminderit.

(Marrë me shkurtime nga gazeta “Shqip”)

Me folë dibranisht

(Vijon nga faqja 5)

Kështu u ndodh një grup demokratësh në një fshat në kufi me Lurën. U sorrollatën poshtë e përpjetë katundit, pa vendosur se ku të trokisnin për t’ia nisur punës. Kështu i gjeti në udhëkryqin e katundit një plak vendali. I pa, i erdhi keq për drojën dhe sikletin e tyre dhe i ftoi në shtëpi, ku zunë vend në bahçe. U qiti kafet, cigaret, por përveç mermërimave dhe fjalëve të zakonshme, askush nuk guxonte të hynte në temë, edhe pse prisnin një “moment psikologjik” të përshtatshëm për t’ia nisur disi. Kur e pa se djemtë ngurronin dhe nuk po merrnin guximin të flisnin, plaku u krijon një situatë alegorike me një paravoli tipike shtendosëse.

“Nji shoqi em luracak, or djem, kishte mbetë midis katër rrugëve – dhe as andej, as këndej. Kryq mes katër rrugëve, ai ia kishte qepë sytë nji peme të naltë ku rreth e rrotull asaj peme sorralleteshin e vinin vërdallë lukuni qensh mbas nji buçe. Kaloj në mëngjes – ai aty. Edhe në drekë – ai aty. Bie n’ara mbasdite, ai aty se aty. Po kur ktheva në mbramje dhe prapë e gjeta aty, i zdrypa kalit dhe e pyeta:

- Bibë or lum majku, çka t’ka gjetë?

- Hall i madh or majk. S’di kah me ia mbajtë!

- Çfarë halli, mor majk?

- Paj, me hy mrenda, nuk m’le Prenda. Me hyp n’pemë, më merren mendtë. Me zdryp poshtë, m’hanë qentë... kështu puna.

Pas qeshjes me analogjinë groteske, ishte krijuar një farë pakti i përshtatshëm që garantonte zhvillimin e bisedës.

Vetë natyra e alegorisë dibrane është një stimuluese aktive për të hyrë në dialog dhe, në dialog e sipër gjithçka e gjen një zgjidhje, pasi vetëm dialogu dhe pjesëmarrja në të, krijon kushtet për përplasjen e mendësive, mentaliteteve, paragjykimeve e kqekuptimeve të ndryshme dhe se vetëm nëpërmjet shtjellës së këtij kuvendimi aktiv, mund të kapërcehen pozicionet fiktive. Si një faktor tepër cilësor i emancipimit të ndërsjelltë komunikativ, kjo formë kuvendimi është një relikte e mbijetuar, të cilën jo vetëm nuk e ka fozilizuar koha, por mund të zbatohet me mjaft kërshëri ndjellëse, për vetë natyrën e përfshirjes në lojë. “Homo Ludens” e filozofit holandez Johan Huizinke, presupozon përfshirjen e njeriut në lojëra konstruktesh logjike dhe, duke përsosur inteligjencën e tij në lojë e sipër, të fitojë përveç zbavitjes edhe një dimension krijues, estetik dhe edukativ. Pikërisht në këtë kuptim, kuvendimi alegorik dibran është një ornament delikat dhe kërkon një qasje, përfshirje dhe receptim të kujdesshëm, si çdo art i dobishëm human, i cili i zgjidh tragjeditë “pa gjak” nëpërmjet terapisë së ligjërimit bisedimor.

A.Tufa

Lura në kujtimet e fratit boshnjak Lovro Mihaçeviç

...Prej Malit Shenjtë zbritëm në fshatin Krejë, ku na duhej ta ndërronim udhërrëfyesin. Mashkull nuk mund të gjenim askund për bé. Krejt mashkullia ishin mbyllur nëpër shtëpia dhe nuk guxonin të dilnin, sepse ato ditë kishin rënë në gjak e gjakmarrja ishte e frikshme. Na dhanë një vajzë dymbëdhjetëvjeçe, të shëndoshë e të shkathët nga goja si ajo, e cila rrugës na tregoi për rastin e vrasjes dhe gjakut që ishte derdhur ato ditë. Pikërisht në mesditë mbërrimë në Lurë, fshat dhe famulli, ku qëndruam te famullitari i atyshëm dy ditë dhe dy net që të pushonim dhe të kënaqeshim me bukurinë e këtij vendi kaq interesant malor, e besa edhe të ngjiteshim në majë të malit Kunora e Lurës, të shihnim me sy për së afërmi mrekullinë e kësaj krahine, liqenin që thonin se ishte një margaritar në majë të atij mali.

Fshati Lura është në lartësi mbi detare 1100 m, ndërsa mali Kunora është 2110 m, pra na duhej për rreth 1010 m të ngjiteshim më këmbë. Duke u nisur nadje herët, me përcjellje të zgjedhur nga vendi, mbërrimë deri tek liqeni në ahishten bredhnajë që ka ngritur kokën krenare drejt qiellit. Ajri është mbushur balzam, nuk ngopesh dot duke marrë frymë, mushkëritë sikur të zgjerohen duke u mbushur ajër, të ngopet kraharori e gjoksi me ajrin e freskët mjekues. Liqeni është i gjatë një kilometër a diçka më i gjërë, nën një mal të shpeshtë e të zi ahu, e buzë liqenit varen degët, kurse toka nën ta është plot degë të thara e krande. Ngjyra e kaltërt në të mbylltë e ujit që shikon, të bën të mendosh se liqeni është shumë i thellë e uji është shumë i ftohtë. Pak më lart mbi këtë liqen të madh, është një tjetër më i vogël, i cili i jep ujë atij të madhit më poshtë.

Mua më interesonte gjithçka që shihja këtu në këtë lartësi prej 2000 metrash dhe u kënaqa brenda dy orëve të plota në qetësi idilike natyrore, por për liqenin mund të them vetëm këtë, madhështor dhe i mrekullueshëm, por i lënë pas dore të Zotit dhe njeriut, kështu që bukuria natyrore me mrekullinë e vet, fsheh vendin e shkretë. Për pesëmbëdhjetë minuta ngjitje, prej këtu dolëm në majë të malit të shikonim çfarë shihet rreth e rrotull. E çfarë të shohësh, o i biri i njeriut. Para syve na tregohet e tërë Shqipëria me bjeshkët kreshnike e vargmalet shqiptare. Në lindje shohim Dibrën e fushëbetejat e trimërisë së pamposhtur të trimit Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe çetave të bashkëluftëtarëve të tij kreshnikë, stolisur, veshur e ngjeshur për betejë.

Shikoj kah çan zemrën e luginës lumi Seta dhe kodrinat e gjelbëruara për rreth tij, ku kushedi sa herë Skënderbeu ka fshehur çetat e tij trime, që në kohë të duhur ta befasojë ndonjë pashë, t’i dalë përballë e ta përshëndesë duke e përqafuar me morden dëshpëruese. E sot? Exoriare aliquis ex assibus nostris ultor! – Lavdi eshtrave të dëshmorëve të vrarë, ata dritë paçin.

Është 5 gushti, ditë e nxehtë por e këndshme, si e dëshiruar, erdh’ koha ta lëshojmë Lurën. Kthehemi në fshatin Krejë dhe ngjitemi malit Valmorë, kalojmë disa përroje e përroçka dhe hymë në bajrakun e Selitës... Në mbrëmje u rrëfyem atyre tërë atë që pamë e dëgjuam dhe përjetuam në Lurë, kurse ata neve na folën për antarët dhe joantarët e famullive të tyre, pra për katolikët dhe muslimanët. Në Lurë muslimanët janë ende gjysmë të krishterë e të krishterët gjysmë muslimanë.

Në Lurë qemë në shtëpinë e një e një katoliku kryeplak i fshatit, i cili kishte vëllaun musliman, njëri festonte krishtlindjet, tjetri bajramin, njëri fëmijët i ka pagëzuar Gjon e Pjetër, tjetri u ka fryrë në vesh emrat Sylë e Osman. Në Lurë katoliku ia jep vajzën muslimanit e muslimani katolikut...

(Marrë nga libri i sapobotuar “Nëpër Shqipëri”)

Gazetën, falë ndihmës së z. Gazmend Kërkuti, mund ta lexoni edhe në internet në adresën: www.dibra.org

Grafika: **Studio “m&b”**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën “**Dita 2000**”. Tel: (04) **273 745**